

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5587
E enjte, 27 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Gjermania i dhuroi FSK-së 44 automjete taktike dhe pajisje të tjera përcjellëse

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" DEPUTETI I KUVENDIT
TË KOSOVËS, VETON BERISHA | FAQE 4-5

Kosova s'ka nevojë për zgjedhje të reja

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, ka thënë se në këtë fazë në të cilën gjendet Kosova më së paku ka nevojë për zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova ka hyrë në procese ndërkom-bëtare dhe, sipas Berishës, as opozita nuk ka interes që në këtë kohë të organizohen zgjedhje të reja. Ai ka thënë se kjo qeveri e ka një qasje më aktive ndaj kërkesave të komunitetit egjiptian dhe ka pohuar se nuk kanë ndonjë arsye për ta përkrahur ndonjë mocion të opozitës për rrëzimin e kësaj qeverie. "Vetëm shpresoj të rritet puna e qeverisë në raport me kërkesat tona", ka thënë Berisha. Duke folur për procesin e dialogut me Serbinë, ai ka theksuar se ky proces duhet ta ketë mbështetjen e Kuvendit të Kosovës



AKTUALE

FOTOSHOP APO DIPLOMACIA FOTOSENSITIVE E LEPURUSHËVE KOSOVARË! F. 11



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

O'CONOLLI: KA ARDHUR KOHA QË KOSOVA TË JETË E PËRGJEGJSHME PËR SUNDIMIN E LIGJIT F. 5

PËRKUJTOHEN DËSHMORËT DHE MARTIRËT E FAMILJES DELIU F. 3

EKONOMI

VESELI VIZITON FERRONIKELIN, PREMTON PËRKRAHJE TË MADHE PËR INVESTITORËT E RINJ NË KOSOVË F. 9

PRODHUESIT KOSOVARË INFORMOHEN LIDHUR ME PROCEDURAT E EKSPORTIMIT PA DOGANË NË SHBA F. 8

KULTURË

AGIM RAMADANI, 'AGIMI I LIRISË' DHE MONOGRAFIA E BEDRI TAHIRIT F. 13

Prof. dr. Sabahajdin CENA

Veteranët kërkojnë miratimin e Ligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës

Qindra veteranë të Dukagjinit kanë protestuar të mërkurën në Prishtinë para Pallatit të Drejtësisë në mbrojtje të vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. Ata kanë paralajmëruar protesta të dhunshme nëse prokuroria deri më 8 tetor nuk e hedh poshtë aktakuzën për veteranët e "rrejtshëm" si dhe nuk kërkon falje. Po ashtu, veteranët kanë kërkuar nga Kuvendi i Kosovës ta miratojë Ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës si dhe ta ndryshojë Ligjin për veteranët e UÇK-së | FAQE 7



Kosova merr mbështetjen e ShBA-së

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të mërkurën me presidentin e ShBA-së, Donald Trump, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasat, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

SPORT

20-VJEÇARI ALIDEMA: DO T'I SHËNOJ 20 GOLA F. 17

Gjermania i dhuroi FSK-së 44 automjete taktike dhe pajisje të tjera përcjellëse

Kontingjenti i KFOR-it gjerman i ka dhuruar të mërkurën Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) automjete dhe pajisje në mbështetje të funksionit që kjo forcë ka në Kosovë. Janë 77 komplete me vegla speciale dhe 44 automjete janë dorëzuar në një ceremoni të veçantë në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rahman Rama dhe shefi i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë dhe Forcën (NALT), gjeneralbrigade Uwe Becker, të mërkurën kanë bërë dorëzim-pranimin e donacionit prej 44 automjeteve taktike dhe 77 kompleteve me pajisje speciale, që Forcat e Armatosura të Gjermanisë i kanë dhuruar FSK-së.

Nënshkrimi të dy gjeneralëve i ka paraparë nënshkrimi i aktit zyrtar të pranim-dorëzimit të donacionit, të cilin në emër të Ministrisë për FSK-në e ka nënshkruar sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj dhe në emër të kontingjentit gjerman të KFOR-it nënkolonel, Eric Offermann.

Në këtë ceremoni morën pjesë edhe zëvendëskryeministri

Enver Hoxhaj, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Cuoci dhe ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, Christian Heldt. Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka thënë se sot është një ditë e veçantë për Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi, sipas tij, donacioni gjerman prej 44 automjeteve ushtarake do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operationale të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri Berisha ka falënderuar Qeverinë e Gjermanisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe popullin gjerman për mbështetjen e vazhdueshme që po jep për Kosovën dhe Forcën e saj. Ndërsa komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rahman Rama, u shpreh falënderues ndaj mbështetjes së vazhdueshme që Forcat e Armatosura të Gjermanisë kanë ofruar dhe po

vazhdojnë të ofrojnë për FSK-në në shumë fusha. "Ishte Gjermania ajo që ngritjen e FSK-së në vitin 2009 e ndihmoi me 204 automjete taktike, pajisje mjekësore, pjesë rezervë etj. Falë kësaj mbështetjeje FSK-ja arriti atë vit kapacitetet e para operationale. Tani, po nga Gjermania, vjen edhe një donacion tjetër, 44 automjete taktike dhe pajisje

përcjellëse", ka thënë Rama, duke shtuar se ky donacion është i rëndësishëm për ta vazhduar rrugëtimin e FSK-së drejt zgjerimit të aftësive dhe vazhdimin e punëve të mira në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe popullit të Kosovës. "Automjetet të cilat po i marrim sot do të jenë në funksion të rritjes së mobilitetit të FSK-së në

nivel taktik, realizimit të detyrave tona, rritjes së standardeve në kuadër të mbështetjes dhe transportit të trupave tanë dhe rritjes së nderveprueshmërisë me Ushtrinë gjermane", ka deklaruar Rama. Në fund të ceremonisë, 44 ushtarë të FSK-së i vunë në lëvizje 44 automjetet që tani e tutje do të drejtohen nga ta për nevojat e FSK-së.



Presidenti Thaçi dekoroi vëllezërit Bytyçi me urdhrin 'Heroi i Kosovës'

NJU JORK, 26 SHTATOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një ceremoni organizuar në Konsullatën e Kosovës në Nju Jork, ka dekoruar me urdhrin "Heroi i Kosovës", tre vëllezërit Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyçi, të vrarë nga forcat serbe si dhe batalionin "Atlantiku" me Medaljen Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Presidenti Thaçi ka theksuar se shqiptarët në Amerikë kanë ndarë kafshatën e bukës për ta mbështetur luftën

në Kosovë. "Ju asgjë nuk keni kursyer për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Në mesin e njerëzve atdhetarë që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në luftime, në fronte të luftës, ishin edhe vëllezërit Bytyçi, të edukuar në një familje atdhetare", ka thënë presidenti Thaçi. Ndërkaq babai i tre vëllezërve, Ahmet Bytyçi, ka thënë se një mirënjohje të tillë gjithmonë e ka pritur, duke shtuar se ajo nuk është vetëm për fëmijët e tij, por për të gjithë të rënë për liri.

Delawie: Çelësi i së ardhmes së Kosovës, në duart e qytetarëve

Prishtinë, 26 shtator - Ambasadori në largim i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Greg Delawie, ka thënë se çelësi i së ardhmes së Kosovës

është në duart e qytetarëve dhe udhëheqësve të saj. "Pres që të shoh të ardhmen e ndritur që ju të gjithë krijoni", ka shkruar Delawie në llogarinë e vet në

"Twitter". Ai ka shkruar se e lë në duart e së ngarkuarës me punë, Colleen Hyland. Në muajin korrik, Shtëpia e Bardhë ka njoftuar për

emërimin e diplomatit Philip S. Kosnett nga Virxhinia si ambasador të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës.



Liderët institucionalë të Kosovës kanë vazhduar takimet në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork

Kosova merr mbështetjen e ShBA-së

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të mërkurën me presidentin e ShBA-së, Donald Trump, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Shefi i shtetit ka postuar fotografi me presidentin amerikan dhe ka shkruar: "Zoti i bekoftë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe miqësinë e përjetshme ndërmjet popujve tanë!" Presidenti Thaçi dhe kryeministri Haradinaj në Nju Jork janë takuar me ndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Wess Mitchell, nga i cili kanë marrë mbështetjen amerikane për shtetin e Kosovës



**EPOKA
ERE** Muhamet KOCI

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar me presidentin e ShBA-së, Donald Trump. Presidenti Thaçi së bashku me Zonjën e Parë të Kosovës, Lumnije Thaçi, kanë realizuar edhe një fotografi me presidentin Trump dhe Zonjën e Parë të Amerikës, Melania Trump. Me këtë rast, Thaçi, i cili ka postuar foto me Trumpin në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar: "Zoti i bekoftë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe miqësinë e përjetshme ndërmjet popujve tanë".

Presidenti Hashim Thaçi, së bashku me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe zëvendëskryeministrin e parë, Behgjet Pacolli, kanë zhvilluar një takim në Nju Jork

edhe me ndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Wess Mitchell. Në këtë takim është biseduar për thellimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy shteteve, për avancimin e agjendës euroatlantike të Kosovës, për procesin e transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës si dhe për fazën e fundit të dialogut për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "ShBA-ja është aleati ynë i përjetshëm. Të gjitha proceset i kemi projektuar dhe finalizuar së bashku. Prandaj, ne asnjëherë nuk do të largohemi nga kjo rrugë. Do të ecim së bashku drejt sfidave të reja që na presin", citohet të ketë thënë Thaçi, sipas komunikatës për medie të Presidencës.

Duke folur për fazën e fundit të dialogut, presidenti Thaçi ka theksuar se mbështetja amerikane në këtë proces është jetike për arritjen e një mar-

rëveshje përfundimtare dhe ligjërisht të obligueshme. Ndërsa ndihmës-sekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Wess Mitchell, sipas komunikatës, ka siguruar presidentin e Kosovës se ShBA-ja do ta vazhdojë mbështetjen e gjithëmbarshme për Kosovën. Po ashtu, presidenti Thaçi së bashku me kryeministrin Haradinaj dhe zëvendëskryeministrin e parë Pacolli kanë zhvilluar një takim me presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk, të cilin e kanë falënderuar për mbështetjen

që i ka dhënë Kosovës në vitet e fundit, duke mbështetur zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe hapjen e perspektivës evropiane për shtetet e Ballkanit Perëndimor. "Si shteti më evropian, Kosova dhe shtetet e tjera të rajonit kanë nevojë për qartësi dhe dinamikë të re të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian", ka thënë presidenti Thaçi.

Në këtë takim është biseduar edhe për procesin e liberalizimit të vizave, për përmbushjen e reformave dhe për fazën e fundit të dialogut për normaliz-

imin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe arritjen e një marrëveshje përfundimtare dhe ligjërisht të detyrueshme.

Një ditë më parë presidenti Thaçi, kryeministri Haradinaj dhe ministri i Jashtëm, Pacolli, kanë zhvilluar takime të ndryshme me përfaqësues të vendeve të tjera të botës, ku kanë kërkuar mbështetjen për Kosovën. Në veçanti, ata kanë kërkuar nga përfaqësuesit e këtyre shteteve votën për anëtarësimin e Kosovës në Interpol.

Hoxhaj e Hoti polemizojnë për liberalizim të vizave

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, e ka akuzuar opozitën se po del kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës në takimin me evropianët, por opozita i ka mohuar këto akuza.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka treguar se qëndrime të tilla të përfaqësuesve të disa partive opozitare i kanë shfaqur në takimin me diplomatët e shteteve anëtare (COWEB) që po e vizitojnë Kosovën për herë të parë. "Opozita sot hapur doli kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Është për keqardhje sjellja e përfaqësuesve të disa partive opozitare në takimin me diplomatët e shteteve anëtare (COWEB) që po e vizitojnë Kosovën për herë të parë. Liberalizimi i vizave nënkupton liri udhëtimi për të



gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë edhe për anëtarët e opozitës. Lajmi i mirë nuk do të vonojë me gjithë agjendat dashakeqëse të një pjese të politikës në Kosovë", ka shkruar Hoxhaj në profilin e vet në

"Facebook". Ndaj këtij qëndrimi të Hoxhajit ka reaguar shefi i Grupit Parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, duke i cilësuar akuzat e tij naive. "Akuza naive dhe e pabazuar e zëvendëskryemi-

nistrin Hoxhaj dëmton rëndë besimin në mes të pozitës dhe opozitës në të vetmen çështje në të cilën ne kemi dhënë përkrahje pa rezervë", ka shkruar Hoti në profilin e tij në "Facebook". Ai ka bërë me dije

se në takimin me përfaqësuesit e të gjitha vendeve të BE-së i ka siguruar se LDK-ja e mbështet fuqishëm agjendën eurointegruese të Kosovës. "Si opozitë kemi mbështetur reformat dhe marrëveshjet në mes të Kosovës dhe BE-së që burojnë nga MSA-ja. Ne si opozitë kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme për marrëveshjet që burojnë nga MSA-ja dhe i kemi votuar të gjitha", ka shkruar Hoti, duke shtuar se roli i LDK-së në këtë drejtim ka qenë konstruktiv. "I falënderova për mbështetjen në Parlamentin Evropian pro liberalizimit të vizave dhe kërkoja që sa më parë të përmbillet kjo çështje edhe në Këshillin e Ministrave, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të mos mbesin të vetmit në Ballkan që nuk mund të lëvizin lirshëm", ka deklaruar Hoti.

Flet për "Epokën e re" deputeti i Kuvendit të Kosovës, Veton Berisha

Kosova s'ka nevojë për z

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, ka thënë se në këtë fazë në të cilën gjendet Kosova më së paku ka nevojë për zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova ka hyrë në procese ndërkombëtare dhe, sipas Berishës, as opozita nuk ka interes që në këtë kohë të organizohen zgjedhje të reja. Ai ka thënë se kjo qeveri e ka një qasje më aktive ndaj kërkesave të komunitetit egjiptian dhe ka pohuar se nuk kanë ndonjë arsye për të përkrahur ndonjë mocion të opozitës për rrëzimin e kësaj qeverie. "Vetëm shpresoj të rritet puna e qeverisë në raport me kërkesat tona", ka thënë Berisha. Duke folur për procesin e dialogut me Serbinë, ai ka theksuar se ky proces duhet ta ketë mbështetjen e Kuvendit të Kosovës



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 SHTATOR -

"Epoka e re": Cilat janë arsyet që iu bashkuat Nismës Socialdemokrate?

Berisha: Në platformën tonë parazgjedhore rritja e numrit të punësimeve dhe rritja e shkallës arsimore, pra zhdukja e analfabetizmit, kanë qenë ndër objektivat tona kryesore. Jam zotuar se do të bëj më të mirën për komunitetin të cilën e përfaqësoj, që ma ka dhënë besim dhe mbështetjen. Prandaj, do të përpiqemi të bëjmë më të mirën në mënyrë që ata ta ndiejnë vetën pjesë e barabartë në shoqërinë në të cilën jetojnë. Marrë parasysh se Nisma Socialdemokrate tani udhëheq resorët kryesorë: Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, kam vendosur t'i bashkohem kësaj partie në mënyrë që të bëjmë më të mirën për elektoratin tonë.

"Epoka e re": Në cilat komuna keni shtrirje më shumë?

Berisha: Thuajse në të gjitha. Në Pejë, Istog, Gjakovë, Prishtinë etj., në të cilat ka numër më të madh të egjiptianëve.

"Epoka e re": Sa i përket çështjes së punësimit si vlerësohet komuniteti egjiptian?

Berisha: Gjendemi në një situatë paksa më të komplikuar, pasi në një anë është përqindja e punësimit që na takon, në anën tjetër Fondi Monetar Ndërkombëtar në vazhdimësi jep vërejtje për mbipopullim të administratës publike, pra jemi në një situatë: hiqe një nga

puna që ta fusim tjetrin në punë.

"Epoka e re": Keni vërejtje sa i përket ndarjes së buxhetit për këtë komunitet?

Berisha: Në kuadër të ndarjeve buxhetore tani hyjnë kërkesat dhe nevojat tona, po ashtu edhe për projektet dhe idetë tona që mund të paraqesim kërkesa. Po punojmë në atë drejtim që të jetë një mbështetje edhe më e mirë sa i përket komunitetit egjiptian.

"Epoka e re": Z. Berisha, tani jeni pjesë e grupit parlamentar të Nismës Socialdemokrate. Do të keni qasje të njëjtë si parti sa i përket formimit të ushtrisë dhe vazhdimit të dialogut me Serbinë?

Berisha: Natyrisht jemi në linjë me Nismën. Komuniteti egjiptian në Kosovë përherë ka qenë pjesë e progresit të shtetformimit dhe ne çdoherë kemi qenë që proceset në Kosovë të ecin përpara dhe assesi të bëhemi pengesë apo të prolongojmë diçka që është në favor të qytetarëve të Kosovës dhe mirëqenies së tyre. Ne asnjëherë nuk kemi insistuar të prolongojmë procese, por të punojmë bashkërisht dhe të shkojmë përpara në mënyrë që në vendin tonë të ketë perspektivë të zhvillimit, arsimimit dhe integritit, por edhe formimit të ushtrisë. Sa i përket dialogut me Serbinë, në këtë mandat shihet se ky proces është i ndjeshëm. Shpresojmë që tashmë kjo fazë e fundit e dialogut ta ketë një fund. Kosova duhet të jetë shumë e përgatitur në procesin e vazhdimit të dialogut me Serbinë. Pra, që të kemi koncepte të qarta në këtë proces. Duhet të hapet debati rreth procesit të dialogut dhe ta ketë një mbështetje nga

Kuvendi i Kosovës. Nuk është në rregull të bëhet debat se kush duhet ta marrë primatin në këtë proces.

"Epoka e re": Z. Berisha, cila është pozita e komunitetit tuaj sot në Kosovë?

Berisha: Prej që jam pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës jam munduar dhe kam punuar në atë drejtim, që t'u sigurojmë punësim, shkollim dhe perspektivë të qartë zhvillimore. Mund të themi se tani ka përparim dhe komuniteti ynë përfaqësohet denjësisht. Në vazhdimësi është punuar dhe po punojmë në mënyrë që ta rrisim punësimin, shkallën e arsimimit dhe ta zhdukim analfabetizmin, të cilën edhe e kemi arritur falë besimit që ma kanë

dhënë qytetarët tanë dhe përkushtimit të punës sonë. Tani pjesëtarët e komunitetit egjiptian janë të punësuar në institucionet tona, pra ne kemi zëvendësministra, nënkryetarë dhe numër të konsiderueshëm të personave me arsim të lartë. Kemi doktorë, profesorë dhe rritje të vazhdueshme të arsimimit. Pra, janë persona që kanë arritur të arsimohen dhe të jenë kuadro profesionale.

"Epoka e re": Z. Berisha, në Kuvend nuk po ka kuorum dhe, për këtë shkak, disa herë janë shtyrë seancat, ndërsa në anën tjetër opozita kërkon zgjedhje të reja duke paralajmëruar rrëzimin e Qeverisë. Cili është qëndrimi juaj në këtë dy çështje?

Berisha: Forma e tillë e bojkotimit në Kuvend nuk është metoda më e mirë. Po të isha pjesë e opozitës, grupeve të mëdha parlamentare do të merrja pjesë dhe do ta bëja kuorumin në mënyrë që projektet që janë për qytetarët të ecin përpara. Kosova është projekt i përbashkët, pra shtet i përbashkët. Ndërkaq sa i përket shkuarjes në zgjedhje të reja, mendoj se nuk ka ndonjë lëvizje që tregon se duhet të shkojmë në zgjedhje të reja. Në këtë fazë në të cilën gjendet Kosova më së paku ka nevojë për zgjedhje. Kosova tashmë ka hyrë në procese ndërkombëtare, në procesin e liberalizimit të vizave dhe dialogut. Unë nuk besoj se as opozita ka interes që në këtë kohë të organizohen zgjedhje të reja.

gjedhje të reja



"Epoka e re": Opozita ka paralajmëruar mocion për rrëzimin e Qeverisë. Do ta përkrahni?

Berisha: Në secilin rast dhe arsye që më jepet për ta rrëzuar qeverinë ndërmarr veprim të bazuar, por jo veprim që shkon në favor të njëjës palë apo tjetrës. Ne kemi një marrëveshje me kryeministrin Haradinaj, e cila është duke u zbatuar jo në masën e duhur, mirëpo gjithmonë me mirëkuptim. Në rastet kur komuniteti përjashtohet prej mundësive të barabarta, kur ne nuk përfillemi në Kuvendin e Kosovës, normalisht se atëherë kemi arsye për t'u larguar prej qeverisë. Kjo qeveri e ka një qasje më aktive, një qasje që të përgjigjet ndaj kërkesave tona. Deri më sot nuk kemi ndonjë arsye për të ndër-

marrë ndonjë veprim sa për të kaluar në anën e opozitës. Si kryetar partie jam besnik i marrëveshjeve. Çfarëdo veprimi që marr, partneri im qeverisë do të jetë i informuar me kohë. Vetëm shpresoj të rritet puna e qeverisë në raport me kërkesat tona.

"Epoka e re": Në zgjedhjet e ardhshme do të jeni pjesë e koalicioneve parazgjedhore, pasi tanimë jeni në Nisma?

Berisha: Unë do të kandidoj sërisht i pavarur dhe nuk bëhem pjesë e koalicioneve parazgjedhore pasi këtë ma garanton Kushtetua e Kosovës. Pastaj do ta shoh se si dhe ku mund t'i arrij objektivat e mia politike, pastaj shohim për koalicionet paszgjedhore.

"Epoka e re": Sa të rinj egjiptianë prisni ta lëshojnë Kosovën pas liberalizimit të vizave?

Berisha: Në këtë aspekt kam shqetësime pasi shumë njerëz liberalizimin e kuptojnë edhe si mundësi punësimi në vendet perëndimore. Shpresoj se do të bëhet liberalizimi dhe të rinjtë tanë do të shkojnë për t'u shkolluar dhe parë përvoja të reja, por kam drojën se do të largohen shumë të rinj marrë parasysh gjendjen ekonomike që kemi në Kosovë dhe me anë të ikjes së tyre apo tentimit për të mbetur apo punuar atje, vërtet që do të dëmtohej imazhi i Kosovës, por në të njëjtën kohë do të jenë edhe barrë për shtetin tonë.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka nënshkruar memorandum me ambasadorin britanik Ruari O'Conolli për mbështetjen e reformave në drejtësi

O'Conolli: Ka ardhur koha që Kosova të jetë e përgjegjshme për sundimin e ligjit

Ambasadori britanik në Kosovë, Ruari O'Conoll, ka theksuar se mënyra më e mirë për t'i luftuar korrupsionin, terrorizmin dhe radikalizmin është duke pasur strukturën e duhur, vullnetin e plotë politik dhe përkrahjen e fuqishme sektori i sundimit të ligjit

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruari O'Conoll, kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshje bashkëpunimi për mbështetjen e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Ministri Tahiri ka theksuar se tashmë faza e parë e kësaj reforme është përmbyllur dhe pritet që edhe Strategjia e Rishikimit Funksional të jetë e gatshme në qershorin e vitit të ardhshëm.

Me memorandumin e ri, Ambasada Britanike do ta mbështesë me ekspertë këtë reformë, konkretisht shtyllën e funksionimit të gjyqësorit. "Edhe kjo strategji synon fuqizimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës,

fuqizimin dhe pavarësinë e gjyqësorit, ngritjen e kapaciteteve që, pa dyshim, lidhet ngushtë edhe me Agjendën që e lansuam dje 'Drejtësia 2020', me të cilën synojmë që në vitin 2020 ta kemi një sistem të drejtësisë i cili nuk ballafaqohet me sfida dhe probleme sikurse ballafaqohet tani", ka thënë ministri Tahiri.

Ambasadori britanik Ruari O'Conoll ka theksuar se mënyra më e mirë për t'i luftuar korrupsionin, terrorizmin dhe radikalizmin është duke pasur strukturën e duhur, vullnetin e plotë politik dhe përkrahjen e fuqishme sektori i sundimit të ligjit. Sipas tij, kosovarët duhet ta tregojnë sërisht trimërinë që e kanë treguar në luftë. "Ka ardhur koha që Kosova të jetë dhe të ndihet, që është shumë e rëndësishme, e përgjegjshme për sundimin e ligjit në Kosovë", ka thënë ambasadori O'Conoll.



Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e familjes Deliu

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë përkujtuar tre dëshmorët dhe 29 martirët e fshatit Abri, në 20-vjetorin e rënies, përkatësisht masakrimit të tyre. Ata kanë thënë se masakra e Abrisë është dëshmi se me çfarë çmimi është paguar liria



sot anëtarët e familjes Deliu, që me gjakun e tyre hodhën themelet e shtetit të Kosovës. Kujtimi për ta është i përjetshëm!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me bashkëpunëtorë kanë bërë homazhe pranë varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Abri. Gjatë përkujtimit të dëshmorëve dhe martirëve të masakrës Deliu, kryetari Lladrovci ka shprehur respektin dhe dhimbjen për familjen Deliu, heronjtë, dëshmorët dhe martirët e masakrave të kryera nga ushtria dhe policia e regjimit serb. Po me rastin e shënimit të 20-vjetorit të tre dëshmorëve, Valdet Xhemajli, Vesel Demaku dhe Afrim Hajdaraj dhe 29 martirëve të fshatit Abri, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" është mbajtur edhe një akademi përkujtimore nën përkujdesjen e kryetarit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

dhe sigurinë e tij", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se masakra e Abrisë është dëshmi se me çfarë çmimi është paguar liria.

"Një nga masakrat më mizore që janë bërë mbi popullin tonë, ajo e Abrisë së Epërme, 20 vjet më parë, ku nuk u kursyen as fëmijët në djep, është dëshmi se me çfarë çmimi është paguar liria. Me përulje përkujtojmë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

DRENAS, 26 SHTATOR - Përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale kanë përkujtuar tre dëshmorë dhe 29 martirë të familjes Deliu në fshatin Abri të Drenasit, të cilët 20 vjet më parë kanë rënë në altarën e lirisë. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se më 26 shtator të vitit 1998 forcat serbe kanë kryer një rënje prej masakrave më të rënda të luftës, atë në familjen Deliu të Abrisë. Ai ka thënë se Abria është monument i historisë më të re të Kosovës. "Nuk u kursyen as foshnjat, as gratë dhe as të

moshuarit. Tronditja ishte e madhe, por edhe më e madhe ishte vendosmëria e popullit tonë për të qëndruar i pathyer në rrugën e lirisë. Abria, Drenica, e gjithë Kosova nuk u thyen. E mposhtën barbarinë më të madhe të fundshekullit XX. Sot, 20 vjet pas, kujtojmë dëshmorët dhe martirët e Abrisë jo vetëm për ta sjellë në vëmendje çmimin e lirisë, por edhe për t'u zotuar se shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës do të qëndrojë përgjithmonë në mbrojtje të lirisë sonë. Abria është monument i kujtesës sonë. Është monument i lirisë sonë. Është zotim i shtetit tonë sovran. Zotim se ky vend kurrë më nuk do të cenohet në lirinë

Panairi i Gjilanit mbledh rreth 120 biznese nga vendi dhe rajoni



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

GJILAN, 26 SHTATOR - Rreth 120 biznese nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi po marrin pjesë në panairin tregtar "Gjilani 2018", i cili ka për qëllim t'i forcojë marrëdhëniet ndërmjet sipërmarrësve nga rajoni dhe për ta inkurajuar konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për një zhvillim stabil ekonomik.

Panairi i njohur si Panaxhyri i Gjilanit do të jetë i hapur deri të premtën.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka premtuar se në vitin e ardhshëm do ta zgjerojnë edhe më shumë kalendarin e panairit, që të ketë edhe më shumë biznese.

Ushtruesja e detyrës së ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Arbëresha Krasniqi, ka potencuar se si ministri do të vazhdojnë të mbështetin panairin të tilla. "MTI-ja do të vazhdojë edhe më tutje mbështetjen e panairëve të tilla, të cilat do t'u japin kuptim bizneseve dhe ekonomisë sonë vendore. Unë ndihem mirë që sot Komuna e Gjilanit i bashkon bizneset mbarërajonale dhe ndihem mirë që këtu ka përfaqësime të bizneseve edhe nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, nga Lugina. Bashkëpunimi ndërmjet bizneseve rajonale sigurisht se e fuqizon ekonominë tonë", është shprehur ajo. Ky panair ka pasur mbështetje edhe nga Ambasada e Shqipërisë në Kosovë, ku nga Shqipëria kanë marrë pjesë 42 biznese.

Ndalohehet deputeti Milaim Zeka

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar të mërkurën se me vendim të Prokurorisë Themelore të Prishtinës ka ndaluar dhe ka dërguar në mbajtje për 48 orë deputetin e Kuvendit të Kosovës nga Nisma Socialdemokrate, Milaim Zeka. Ndalimin e tij e ka konfirmuar edhe avokati i Zekës, Gazmend Halilaj. Ai ka thënë se arsyeja e ndalimit të Milaim Zekës është kinse për kanosje përmes mjeteve të informimit, ndaj prokurorit të

Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Afrim Shefkiu. Një ditë më parë Këshilli Prokurorial i Kosovës kishte dënuar ashpër deklarimet publike dhe kërcënimet, të cilat kohët e fundit janë drejtuar ndaj prokurorëve të shtetit, në veçanti deklarimin kërcënues të deputetit Milaim Zeka ndaj prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Afrim Shefkiu.

Monitorues të KMDLNj-së kanë vizituar deputetin Milaim Zeka në Qendrën e Ndalimit në Prishtinë. Me këtë rast, ata kanë konstatuar se gjatë arrestimit, marrjes në pyetje dhe mbajtjes në këtë qendër ndaj deputetit Zeka janë respektuar të drejtat e parapara për persona të privuar nga liria. Pavarësisht prej kësaj, KMDLNj-ja ka theksuar se ndalimi i Zekës është politik dhe nuk ka të bëjë me arsyetimin që e ka dhënë prokuroria, për kanosje.



Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protesta të dhunshme nëse nuk hedhet poshtë aktakuza për veteranët e "rrejshëm"

Veteranët kërkojnë miratimin e Ligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës

Qindra veteranë të Dukagjinit kanë protestuar të mërkurën në Prishtinë para Pallatit të Drejtësisë në mbrojtje të vlerave të luftës dhe dinjitetit të luftëtarit të UÇK-së. Ata kanë paralajmëruar protesta të dhunshme nëse prokuroria deri më 8 tetor nuk e hedhë poshtë aktakuzën për veteranët e "rrejshëm" si dhe nuk kërkon falje. Po ashtu, veteranët kanë kërkuar nga Kuvendi i Kosovës ta miratojë Ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës si dhe ta ndryshojë Ligjin për veteranët e UÇK-së



Përfaqësuesi i veteranëve të Dukagjinit, Avdyl Mushkolaj, ka thënë se Prokuroria e shtetit ka shkelur dinjitetin e luftës me publikimin e listave të veteranëve të "rrejshëm". "Duhet të hedhet poshtë si e pabazë aktakuza e prokurorisë në rastin e veteranëve. Çdo gabim që ka ndodhur gjatë verifikimit të veteranëve jemi ne luftëtarët që do të kontribuojmë në pastrimin e tyre në bashkëpunim me komisionin qeveritar apo çfarëdo organi që caktohet nga qeveria për këtë qëllim. Në afat kohor deri më 8 tetor 2018 ne presim përgjigje publike rreth kërkesave tona siç është hedhja poshtë e aktakuzës dhe kërkimfalja e prokurorisë për denigrimin e vlerave të luftës dhe dinjitetin e

veteranit. Nëse prokuroria nuk përmbush këto kërkesa, veteranët do t'i përshkallëzojnë protestat e tyre. Protestat e radhës nuk do të jenë paqësore. Ne nuk luftuam dhe nuk ndërtuam paqe që elementi serbojugosllav ta vazhdojë persekutimin tonë ashtu si në kohën e okupimit", ka deklaruar Mushkolaj, duke shtuar se veteranët e UÇK-së kanë luftuar për shtet juridik e jo për struktura qesharake të drejtësisë që kontrollohen nga faktorët e jashtëm sipas interesave të tyre ditore. Sipas tij, nëse rrezikohet territori i vendit veteranët janë të gatshëm të marrin sërish pushkën, ngaqë kanë luftuar vetëm për liri. "U ngritëm kur nuk kishte asnjë shpresë, kur Kosova ishte djegur, kur na dëbuan nga shkolla, kur na burgosën. UÇK-ja ishte drita në fund të tunelit. Ne nuk deshëm asgjë përveç lirisë. Faleminderit Kosovë! Nëse ke nevojë, prapë do të luftojmë për ty", ka theksuar Mushkolaj. Ai ka thënë se 20 vjet pas kryengritjes gjithëpopullore shteti për të cilin veteranët dhanë gjithçka po i ofendon, gjykon e persekuton para shoqërisë. "Sot u mblodhëm jo me dëshirën tonë, por për kundërshtimin e padrejtësitë që po u bëhet luftëtarëve. U persekutuam nga UNMIK-u, EULEX-i Haga dhe sot po persekutohemi nga institucionet tona", ka thënë ai. Mushkolaj ka kërkuar që Kuvendi i Kosovës të miratojë sa më shpejt Ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës si dhe ta ndryshojë Ligjin për veteranët e

UÇK-së. "Kërkojmë që Kuvendi ta miratojë Ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës. Kërkojmë që Kuvendi ta ndryshojë Ligjin për veteranët dhe në hartimin e këtyre ndryshimeve të marrin pjesë ata që e kuptojnë luftën dhe vlerat e saj e jo burokratët e zyrave ministrore", është shprehur ai.

Pjesë e protestës ka qenë edhe deputetja Time Kadrijaj, emri i së cilës është publikuar me listën e veteranëve të "rrejshëm". Me këtë rast ajo ka thënë se fushata kundër UÇK-së duhet të ndërpritet. Kadrijaj ka vlerësuar se publikimi i listave ka qenë një turp i shtetit të Kosovës që ka denigruar luftën e UÇK-së si dhe veteranët e vërtetë. "Veteranët kanë dalë për të kërkuar drejtësi. Publikimi i listave ka qenë një turp i shtetit të Kosovës që ka denigruar luftën e UÇK-së si dhe veteranët e vërtetë. Kjo fushatë kundër UÇK-së duhet të ndërpritet. Publikimi i atyre listave është cenim i integritetit dhe i lirisë së individëve sepse publikimi i të dhënave personale është antiligjore. Është shumë e drejtë që veteranët kanë dalë për të kërkuar drejtësi", ka deklaruar Kadrijaj.

EPOKA
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 SHTATOR - "Mashtrues jeni ju, jo ne", "Nuk i dua lekët, po as ofendimin", "1 700 veteranë të vdekur, 50 të vetëvrarë" këto kanë qenë pankartat me të cilat kanë protestuar veteranët e Dukagjinit të mërkurën para Pallatit të Drejtësisë në Prishtinë për të kërkuar drejtësi për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nëse deri më 8 tetor prokuroria nuk heq dorë nga aktakuza për veteranët e "rrejshëm" si dhe nuk kërkon falje për denigrimin që ua ka bërë vlerave të luftës, organizatorët e kësaj proteste kanë paralajmëruar protesta të dhunshme.




Kosova dhe Shqipëria do t'i bashkërendojnë politikat shëndetësore

TIRANË, 26 SHTATOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, është takuar të mërkurën në Tiranë me ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Shqipërisë, Ogerta Manastirliu, me të cilën ka biseduar për bashkërendimin e politikave shëndetësore në mes të dy vendeve. "Vizitë sa miqësore aq edhe frytdhënëse në Shqipëri. Është kënaqësi ta shohësh punën e mirë që ministrja e Shëndetësisë

dhe Mirëqenies Sociale, Ogerta Manastirliu, ka bërë atje. Kosova dhe Shqipëria do t'i bashkërendojnë politikat shëndetësore, që reformat të cilat kemi nisur në të dy vendet në sektorin shëndetësor gjatë kësaj qeverisjeje, të zhvillohen mbi bazën e një bashkëpunimi sa më të madh", ka thënë ministri Ismaili. Ai ka thënë se Shqipëria ka kaluar nëpër procese të reformave shëndetësore kohë

më parë, në veçanti sa i përket funksionalizimit të sigurimeve shëndetësore. "Andaj edhe do të kemi nevojë për përvijën e ekspertëve shqiptarë në këtë proces, e cila na u garantua se nuk do të mungojë. Falënderoj ministren Manastirliu për pritjen e ngrohtë dhe mbështetjen e shtetit shqiptar për t'i ndihmuar reformat në shëndetësinë e Kosovës", ka deklaruar ministri Ismaili.



Prodhuesit kosovarë informohen lidhur me procedurat e eksportimit pa doganë në ShBA

PRISHTINE, 26 SHTATOR (ER) - Vlera e eksporteve të mallrave të Kosovës në tregun amerikan vazhdon të mbetet e vogël, pavarësisht se Kosova është përfutur e Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave të Shteteve të Bashkuara (GSP) i cili mundëson trajtim pa doganë për më shumë se 3 500 produkte të ndryshme. Kjo u bë

me dije të mërkurën në një punëtori të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Ambasadën e Republikës së Kosovës në ShBA dhe Zyrën e Përfaqësuesit Tregtar të ShBA-së (USTR) lidhur me përfitimet të cilat dalin nga statusi preferencial tregtar

që Kosova gëzon me ShBA-në në kuadër të sistemit GSP. Arian Zeka, drejtor ekzekutiv i Odës Amerikane, ka thënë se sistemi preferencial tregtar GSP ofron trajtim pa doganë për një numër të madh produktesh për vendet në zhvillim, përfshirë Kosovën. Ai ka shtuar se eksportet e kufizuara në ShBA sugjerojnë mungesë të infor-

matave lidhur me mundësitë që dalin nga ky status, duke u zotuar se Oda Amerikane do të vazhdojë të jetë në dispozicion të tyre për ofrimin e informatave për bizneset e interesuara. Abel Lomax, zyrtar ekonomik dhe komercial i Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, ka thënë se Kosova gjatë viteve të fundit

ka shënuar progres në fusha të ndryshme, përfshirë këtu rritjen e eksporteve në ShBA. Punëtorja ishte një mundësi e mirë për kompanitë prodhuese nga Kosova që të informohen lidhur me statusin preferencial tregtar, kategoritë e produkteve që eksportohen në ShBA si dhe lidhur me procedurat e realizimit të këtyre përfitimeve.



Osman Vishaj propozohet për ta udhëhequr KRPP-në

EPOKA E

A. MAVRAJ

PRISHTINE, 26 SHTATOR - Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, e cila është kryesuar nga nënkryetarja e këtij komisioni, Safete Hadergjonaj. Me shumicë votash është vendosur të dërgohet për në seancë plenare për votim emri i Osman Vishajt, i cili është rekomanduar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta udhëheqë Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP-në). Kryesuesja e këtij komisioni, Safete Hadergjonaj, ka thënë se personi në fjalë i plotëson

kriteret e kërkuara dhe ka dërguar CV-në e tij, me anë të së cilës është dëshmuar që nuk është nën hetime apo i akuzuar për ndonjë vepër penale. Dardan Molliqaj nga PSD-ja ka thënë se e njeh personalisht Vishajn dhe, sipas tij, ai ka integritet profesional dhe moral. Ndërkaq deputetja e LV-së, Arbërie Nagafci, ka hedhur dyshime tek Vishaj lidhur me akuzën për keqpërdorim të detyrës zyrtare në QKUK. Mirëpo, deputetja e PDK-së, Safete Hadergjonaj, ka thënë se Vishaj ka dërguar dëshmi nga gjykata që nuk është nën hetime.

Emri për kryetar të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik



propozohet nga Qeveria dhe emërohet nga Kuvendi me mandat pesë vjet. Po në këtë mbledhje është marrë vendim që t'i

dërgohen Kuvendit për miratim pesë emra për Fondin Pensional të Kosovës. Për kryesues të bordit është propozuar Ruzhdi Morina,

ndërkaq për anëtar janë propozuar: Frederika Artesani, Behxhet Haliti, Driton Qehaja si dhe Imer Imeri.

Krasniqi: Mbështetja e MBPZhR-së po e stimulon sektorin e qumështit



PRISHTINE, 26 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Shoqatës së Industrisë Përpunuese të Qumështit, Gani Durmishaj, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet e përgjithshme në industrinë e qumështit, si dhe për mbështetjen e ministrisë për

avancimin e mëtejshëm të kësaj industrie. Me këtë rast, zëvendësministri Krasniqi i ka njoftuar ata më hollësisht për ecurinë e realizimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në kuadër të të cilit ai ka theksuar se kanë gjetur mbështetje të madhe fermerët e industrisë përpunuese të qumështit. Ai i ka njoftuar ata se buxheti i ndarë për mbështetjen e

këtij sektori, si përmes granteve investive dhe subvencioneve, do të ndikojë që ky sektor të zhvillohet dhe të rritet cilësia e prodhimeve vendore të qumështit. Zëvendësministri Krasniqi u ka premtuar atyre se do të jenë partner serioz për MBPZhR-në për zbatimin e politikave dhe programeve mbështetëse për fermerët.

Veseli viziton Ferronikelin, premtion përkrähje të madhe për investitorët e rinj në Kosovë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

DRENAS, 26 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar të mërkurën kompaninë "NewCo Ferronikeli" në Drenas. Gjatë vizitës së tij Veseli ka theksuar rëndësinë e kësaj kompanie jo vetëm për Komunën e Drenasit dhe për impaktin që ajo ka për krijimin e mirëqenies së qindra punëtorëve të këtij rajoni,

por edhe për tërë Kosovën. Ai ka thënë se tashmë në Ferronikel është një investitor serioz, i cili në një afat rekord ka arritur ta riaktivizojë prodhimin dhe t'i paguajë pagesat e punëtorëve, të cilët mbajnë afër një mijë familje. "Institucionet e Kosovës do t'u japin përkrähje të vazhdueshme investitorëve. Kemi projektligjin e ri në shqyrtim, i cili do t'u japë perspektivë edhe më të madhe atyre. Janë burime të cilat presin, sikurse

krenaria e Kosovës, Trepça, e cila me ligjin e ri do të ketë një transformim dhe do të ndikojë në rritjen e eksportit, të ekonomisë kosovare, punësimit dhe të perspektivës së Kosovës", është shprehur kryeparlamentari Veseli. Ai i ka ftuar investitorët e huaj të investojnë në Kosovë, në energji, miniera, prodhim dhe shërbime të tjera ngaqë, sipas tij, Kosova është një vend i lirë, me ligje stimuluuese për investitorë.

Kreu i Kuvendit ka folur fjalë miradije për investitorin e ri të Ferronikelit, të cilin e ka konsideruar njërin prej investitorëve më të mëdhenj në hapësirat shqiptare dhe më tej. "Të gjithë janë të kënaqur që fabrika e Ferronikelit është rikthyer në punë me kapacitet të plotë të prodhimit, si dhe me investimet e bëra nga investitori i ri, Grupi Balfin. Institucionet tona do të vazhdojnë të japin përkrähje të fuqishme në

zgjerrimin e kapaciteteve operative dhe prodhuese të kësaj fabrike", ka theksuar Veseli. Pronari i ri i Ferronikelit, Samir Mane, ka falënderuar kryeparlamentarin Veseli për vizitën dhe mbështetjen e tij. "Do të ofroj përkrähje të plotë për Ferronikelin, për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, për krijimin e vendeve të reja të punës dhe për bashkëpunimin e afërt me komunitetin e saj", ka deklaruar Mane.

MTI-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Korporatën Financiare Ndërkombëtare

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore, që përfaqësohet nga Damien Shiels, menaxher i Praktikës Globale për ICF-në dhe Patrickun, që përfaqëson

Agjencinë Zvicerane për Zhvillim (SECO). Ushtruesja e detyrës së ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, e ka vlerësuar lart punën dhe partneritetin e deritashëm me IFC-në. Krasniqi ka falënderuar Qeverinë zvicerane dhe SEKO-n si ndër donatorët më aktivë në Kosovë, që e

përkrähin edhe këtë projekt të rëndësishëm për MTI-në. Krasniqi ka thënë se në kuadër të këtij projekti do të përfshihen këto aktivitete: rishikimi i paaftësisë së kryerjes së pagesave dhe ligjeve të tjera për t'i larguar paqartësitë e mundshme dhe pengesat e tjera për zbatimin e procesit të falimentimit.



Në Berishë të Malishevës iu dha lamtumira e fundit atdhetarit Hamit Selman Berisha

"Familja Berisha i dha vendit mendimtarë të shquar dhe vizionarë që dinin ta orientonin popullin drejt çlirimit nga robëria shekullore", ka thënë dr. Mehmet Rukiqi me rastin e varrimit të Hamit Selman Berishës

A. ZOGAJ

MALISHEVË, 26 SHTATOR - Miq dhe dashamirë të shumtë, më 25 shtator, ai kishin mësyre fshatit Berishë për t'ia dhënë lamtumirën e fundit Hamit Selman Berishës, i cili u nda nga jeta pas një sëmundje të shkurtër në orët e vona të 23 shtatorit.

Hamit Selman Berisha lindi në fshatin Berishë më 1936, në një familje me traditë atdhetare, e cila e dëshmoi veten gjatë historisë me qëndresë, besë dhe trimëri. Sipas shënimeve të librit "Ditar e kujtime të një refugjati", të autorit Hamit Berisha, Hamiti tri klasë të fillores i kreu në Kishnarekë, ndërkaq pas përjashtimit në vitin 1949, klasën e katërt e vazhdoi në Sedllar. Një pjesë të shkollimit e përfundoi në Arllat dhe Prishtinë. Në vitin 1953 organet e pushtetit jugosllav e burgosin, nën akuzën se ishte armik i Jugosllavisë dhe se ishte i indoktrinuar nga kushëriri i tij, Rifat Berisha, që për qëllim kishin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Në burg qëndroi nga 12 gushti i vitit 1953 e deri në fund të atij viti.

Rrugëtimi i shkollimit të Hamit Berishës ishte shumë i vështirë, sikurse ishte për gjithë familjen e gjerë Berisha e cila ishte halë në sy për pushtetin jugosllav. Peripeci të shumta e përcollën edhe gjatë punësimit ku, për shkak të bindjeve politike dhe të kaluarës së familjes së tij, disa herë u largua nga puna.


Hamit Berisha ishte jurist i diplomuar i cili gjatë gjithë karrierës së vet punoi dhe jetoi me nder, duke lënë kujtime dhe përshtypje të mira tek të gjitha ata që e kanë njohur dhe kanë pasur rastin të punojnë me të. Ndërkaq, lexuesit i ka lënë një libër të çmuar "Ditar e kujtime të një refugjati" botuar në vitin 2006 nga Sh.B. "Shkrola". Në këtë ditar lexuesit do të gjejë histori, letërsi, ngjarje dhe ndodhi të thëna në retrospektivë, deri te përjetimet e autorit në jetën e një refugjati të luftës së fundit në Maqedoni.

Në ceremoninë mortore në Berishë të Malishevës, ndër shumë të pranishëm ishte edhe dr. Mehmet Rukiqi, i cili, në fjalën mortore për të ndjerin Hamit Berisha, tha: "Të rralla janë ditët që sjellin pikëllim të

thellë sikur sot kur Hamit Berisha vetëm fizikisht po ndahet prej nesh. Familja Berisha i dha vendit mendimtarë të shquar dhe vizionarë që dinin ta orientonin popullin drejt çlirimit nga robëria shekullore. Nga kjo familje dolën luftëtarë, oficerë, dëshmorë dhe intelektualë të profileve të ndryshme. Hamiti ishte kushëriri i afërm i Tahir Berishës, mendari erudit dhe vizionari më i madh popullor i shekullit të tij", ka vlerësuar Rukiqi.

Sipas Rukiqit, Hamiti herët jepte shenja të një personaliteti me ndërgjegje të lartë, i qëndronte pranë babës Lilë, siç e quante ai dhe familja në tërësi, kurse në formimin e personalitetit të tij, ndikoi rënia heroike e Rifat Berishës me kushërinj, i cili ishte ndër të parët që i tha jo Serbisë, duke ia kthyer plumbat në gjoks ushtrisë serbe në Gajrak të Malishevës.

Të pranishëm në këtë ceremoni mortore ishte edhe familja Berisha nga Tirana, respektivisht Muhamer dhe Shpresa Berisha (fëmijët e Rifat Berishës) si dhe mbesat Dajana, Elira dhe nipi i Rifatit, Ermali.



Komuna paralajmëron masa ndëshkuese ndaj borxhlinjve të mbeturinave

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Komuna e Prishtinës nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se kushdo që nuk i paguan tri fatura radhazi të mbeturinave nuk do të mund të kryejë shërbime në disa drejtori komunale. Pagesa për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është obligim për secilin amvisëri dhe secilin biznes. "Rregullorja komunale parasheh masat që ndërmerr komuna ndaj atyre që nuk janë të rregullt me pagesa. Kushdo që nuk i paguan tri fatura radhazi nuk mund të marrë shërbim në: Drejtorinë për Kadastër, Drejtorinë për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorinë për Financa, Drejtorinë për Pronë, Drejtorinë për Inspeksion, Zyrën për Prokurim. Duke e ditur që tashmë jemi në fund të shtatorit, pra në fund të tremu-



porit të tretë, u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve dhe bizneseve ta kryejnë pagesën për muajt paraprakë, ashtu që të mos i aplikojmë masat administrative që u theksuan më sipër. Të kontribuojmë të gjithë bashkë, për një kryeqytet sa më të pastër", është thënë në komunikatën për medie të Komunës së Prishtinës. Në vazhdimin e kësaj komunikate është theksuar se që nga

janari i këtij viti Komuna e Prishtinës ka reformuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave, me qëllim që të ketë shtrirje më të madhe në terren ky shërbim si dhe të rritet efikasiteti. Në kuadër të kësaj reforme qytetarët faturohen një herë në tre muajt dhe pagesën mund të bëjnë në komunë, në postë, si dhe në institucione financiare.

Kuvendi Komunal i Rahovecit miraton buxhetin për vitin 2019

RAHOVEC, 26 SHTATOR (ER) - Kuvendi Komunal i Rahovecit të mërkurën ka miratuar buxhetin e kësaj komune për vitin 2019 si dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2019-2021. Në favor të këtij buxheti kanë qenë 17 asamblistë, tre kundër dhe tetë kanë abstenuar. Buxheti i miratuar i Komunës së Rahovecit për vitin

2019 është 13 milionë e 658 mijë e 391 euro, i shpërndarë në këto kategori ekonomike: paga dhe mëditje 7 milionë e 435 mijë e 669 euro, mallra dhe shërbime 1 milion e 514 mijë e 331 euro, shpenzime komunale 255 mijë e 500 euro, subvencione dhe transfere 250 mijë euro dhe investime kapitale 4 milionë e 203 mijë e 391 euro.



Fotoshop apo diplomacia fotosensitive e lepurushëve kosovarë!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Trampi, Krrapi dhe Trapi: Para se të bëjë përpjekje të shkarravis diçka duhet, për shkak të korrektësisë dhe respektimit të drejtave të autorit, të them se shprehjet fotoshop dhe fotosensitive janë të mikut tim Blerimit (Latifi), i cili bënte përpjekje, si filozof profesionist që është, të më udhëzojë mua, si analfabet profesionist që jam, se si duhet të përdoren dhe kur duhet të përdoren këto shprehje duke menduar se unë e kam kokën e akademikëve legjendarë siç janë Nexhat Presheva dhe Hivzi Medvegja (apo përkthyer në shqip, Hivzi Arinxhiu) prandaj mos ma shihni për të madhe nëse i keqpërdori këto shprehje. Pra, për çdo mosmarrëveshje eventuale përgjegjësia bie mbi mësuesin (Blerimin) e jo mbi nxënësin e keq (Behxhetin).

Po tash, pasi botërisht ia pranova autorësinë e këtyre shprehjeve Blerimit, ndonëse sipas ligjeve të Kosovës dhe autoritetit suprem intelektual Enver Baba, është e lejuar, madje afirmative nëse kopjoj afërsisht 70 për qind të djersës së të tjerëve, duke qenë shumë i kujdesshëm që mos ta kaloj këtë shifër magjike prej 70 përqindësh sepse, në të kundërtën, mund të më denoncojnë për plagjiaturë, ORCA apo BURCA, ndonëse shkrimet e mia nuk i publikoj në gazetata apo revista e Indisë, por në gazetata e Dukagjinit dhe të Drenicës. Për dallim nga Serbia që tërë diplomacinë e saj e ka ndërtuar mbi të pavërteta, që nga babai i diplomacisë sllave, Nikolla Pashiq, i cili si argument kryesor diplomatik e ka konsideruar dhe përdorur rrenën e që e ka pranuar edhe botërisht, diplomatët e rryer kosovarë kurrë dhe asnjëherë, gjatë aktivitetit të tyre jashtëzakonisht të suksesshëm diplomatik, nuk i kanë gënjyer as miqtë e as armiqtë! Kosova ka të ndërtuar dhe të konsoliduar shërbimin diplomatik sipas standardeve më të larta të shkollës për Diplomaci dhe Ndërmjetësim të Muçibabës, si dhe shkollës për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim të Gjylekarës. Realisht do t'i hyja në hak dhe do të bëja padrejtësi nëse këtu nuk e përmendi edhe Akademinë për Diplomaci dhe Kurvëri (kryesisht politike) të Bashkurcit e cila ka nxjerrë një plejadë të lavdishme diplomatësh

kosovarë, disa prej tyre, ndonëse analfabetë, kanë shkruar edhe libra.

Pas përfundimit të luftës së lavdishme të UÇK-së që e solli këtë liri që disa, as nuk e kanë merituar e as që e pranojnë duke frymuar me ritmin e lirisë jugosllave dhe serbe, u paraqit nevojë e domosdoshme të aktivizohet diplomacia kosovare e që ashtu edhe u bë.

Ministri i parë i Jashtëm i Kosovës, me letra, ishte diplomati i shkollës vjeneze, miku im dhe vendësi im gjithashtu, Skender Hyseni. Kishte shije për muzikë dhe njohës i mirë i veprave të Shtrausit, Çajkovskit, Bisesë, Shyhretes, Mocartit dhe Tarkanit, si dhe njohës i mirë i verërave dhe gastronomisë, na e zbardhi fytyrën (për ata që e patën) kudo që shkoj. Dhe, ai ishte dhe mbeti doajeni i diplomacisë kosovare apo, siç thuhet te ne, legjendë e gjallë e diplomacisë. E pati një gabim të vogël, apo salto mortale (shprehje imja dhe jo e Blerimit) e që përfundoi si ministër për punë të brendshme. Nuk është fort e pëlqyeshme që shkopin dirigjues të diplomacisë ta zëvendësosh me shkopin e bejsbollit apo pendrekun e policisë!

Pas Skendes, sipas modelit të diktaturës komuniste të Enver Hoxhës, e patëm diktaturën diplomatike të Enver Hoxhajt. Duket se Enver Hoxhaj që në kohën e pelenave apo pampersave (nëse i ka mbërritur) e ka pasur të shkruar të bëhet diplomat. Kjo për faktin se, sipas një studimi malazias për parashikimin e karrierës, një fëmijë që e bënë m.t në të gjitha anët dhe përsëri qesh sikur të ishte prodhuesi më i madh i mjaltit, pa asnjë dyshim se do të bëhet politikan i shquar apo diplomatik që ia kalon edhe Çerçillit dhe Pashiqit. Enver Hoxhaj i ka këto kualitete por, të jem i sinqertë me të dhe opinionin, e ka një cilësi që rrallëkush e ka, kurrë në jetën e tij private dhe diplomatike nuk ka gënjyer!

Pastaj, një kohë ishte kryediplomat edhe presidenti ynë legjendar, Hashim Thaçi, derisa me ndihmën e disa kurtizaneve dhe kurtizaneve (kurvarë dhe kurva) politike dhe jopolitike u bë president legjendar me mandat deri më 1 tetor të vitit 2019. Edhe ky, sipas parashikimit malazias, që nga pelenat që i janë larë në përrorskën e Burojës, pasi i ka mbushur burrërisht, e ka pasur të garantuar karrierën politike që edhe u jetësua maksimalisht. Si shef dhe shok i Enverit (Hoxhaj), kurrë në jetën e tij, nëse llogaritet me moshë, është relativisht i ri, kurse sa iu përket vuajtjeve dhe angazhimit kombëtar, politik dhe global, del se e ka moshën e Metuzalemit (që flitet se kanë jet-

uar 900 vjet), nuk ka gënjyer apo mashtruar dikë. Prandaj, nga mësuesi i mirë (Hashim Thaçi) del edhe nxënësi më i mirë, apo sipas vlerësimit tim, shembullor e ai është Enver Hoxhaj.

Para se të shkruaj për kryediplomatit e fundit kosovar dhe jo vetëm kosovar, Begjetin nga Mareci, botërisht e pranoj se për mua politikani më i kompletuar, më i shkolluar, më sakrifikuuesi dhe më i mençuri ka qenë Hasan Prishtina. Ka qenë sepse më nuk është pasi në skenë dolën dy politikanë, njëri vetëm politikan, Zafir Berisha, i dyti edhe politikan edhe kryediplomat, Begjet Pacolli. Kam qenë shumë naiv kur mendoja se politikani i vetëm që mund të krahasohet me Hasan Prishtinën ishte Baca Adem Demaçi, por se u binda që nuk është ashtu. Madje tash askush nuk po e përmend, sikur të kishte jetuar në kohën para Agronit dhe mbretëreshës Teutë. Pastaj, po të ishte Baca Adem patriot, këta patriotët e shkollës së Titos të Kumrovcit, shkollës së Rankoviçit dhe Sllobodan Millosheviçit nga Pozharevci e që janë ashtëzuar në një pjesë të LDK-së, nuk do ta bojkotonin edhe për së vdekuri. Pra, aktualisht i kam dy idolë në politikë, Zafir Bershën dhe Behgjet Pacollin e që, për shëndetin, dhe jetën e gjatë që ua dëshiroj e sidomos për mendjen e ndritur që e kanë, e kam fljuar një kurban. Lëreni tash Zafirin, se për të kam shkruar edhe herën e fundit kur parashikova se do të bëhet president i ardhshëm. Edhe Begja ka pretendime, por edhe premtime se, pasi të arkivohet Hashim Thaçi, Begjet Pacolli do të bëhet president i përjetshëm, sikur Josip Broz Tito, të cilin Begja e kishte parë nudo apo cipricullak për ata që nuk e kuptojnë fjalën nudo e që këtë fjalë edhe unë e kam dëgjuar për herë të parë dje, prandaj u nguta ta përdor në këtë shkrim sepse nesër mund edhe ta harroj kuptimin e kësaj fjale. Në fund të fundit, populli i Kosovës, i madh dhe i vogël, i moshuar apo i ri, mashkull apo femër apo të dyja bashkë, i djathtë apo i majtë, ai që ha kallamari apo që meriton kallakari, llapjan, drenicas, duk-agjinas, amatoras i Luginës së Preshevës apo nëntokës së Kosovës (Trepça etj.) nuk do të humbasin asgjë nëse njëri apo tjetri do të bëhej president i Kosovës. Personalisht, sa i përket trashëgimisë patriotike dhe politike, pas arkivimit të Hashimit, mendoj se i merituari për president të Kosovës është Behgjet Pacolli. Zafir shumë më pëlqen, në shumë raste më impresionon por, në rrafshin kombëtar, emancipimit politik, gjenetikës tradicionale, rrjedhshmërisë së përdoruri gjuhën shqipe dhe respektimit të rregullave të drejtshkrim-

it, është shumë prapa Begjës i cili, po të mos ishte Eqrem Qabej, do të ishte njëshi shqiptar. Pastaj, Zafir po del të jetë i dhunshëm, po përdor fjalor të dhunshëm përkundër Begjes që është engjëlli vetë apo melaqja e Kosovës. Kurrë nga goja e tij nuk del ndonjë fjalë e rëndë, nuk ka urrejtje as ndaj Ivica Daçiçit e lëre më të tjerëve, një ish-krimineli siç është Aleksandar Vuçiqi i jep leje për të ardhur në Kosovë kur të dojë, të flasë çka të dojë dhe të bëjë çka të dojë. Begja, si njeri i traditës, nderit, njerëzillëkut, korrektësisë, bujarisë, filantropisë, besës dhe fjalës së dhënë, nuk po ka problem me Vuçiqin, por me këta të Drenicës që nuk po ia respektojnë mysafirin e që ia kthyen prapë. Kushdo që nuk e njeh Begjën mendon se ai është koç...vogël sepse butësia, brishtësia, ndjeshmëria, sensualiteti, seksualiteti, oportuniteti, kualiteti, kuantiteti (e zgjata pak si shumë) vetëm sa ju mashtron, një koç... e Begjës peshon 25 okë, kurse të dyja po del se janë 20 okë. Më i vlefshëm është testosteroni i Begjës se truri i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Kam edhe shumë për të shkruar por, për momentin, nuk po gjej shprehje që, jo se e glorifikon figurën dhe personalitetin e shokut Begjo, por që në mënyrën më modeste të mundshme e pasqyron këtë diamant kombëtar dhe politik të Kosovës shumetnike!

Diçka për nëntitullin: Sa isha në Burgun e Foçës me Rexhep Malën, Skender Kastratin dhe Agim Sylejmanin, ishte një boshnjak pak si i trashë në mendje me të cilin bënin shaka të burgosurit e tjerë, duke i thënë se është "sitna riba" apo "peshk i vogël" dhe duke aluduar se peshku nuk ka tru. Për të dëshmuar se nuk ishte peshk i vogël dhe se ka tru, Muniri u thoshte atyre që e përqeshnin: "Za neke sam sitna riba, za druge sam som", "për disa jam peshk i vogël, kurse për disa jam krap", duke mos e ditur se "som" apo krap përdorej si sinonim i një budallai të madh apo leshkoje.

Është bërë si rregull që ministrat për punë të jashtme apo ministra për çështje botore të Kosovës, e kanë shumë për qejf të dalin në foto me figura të mëdha të politikës botërore apo koç...mëdhënje që marrin vendime për ata që i kanë koç...t e atrofua (të rrudhura apo të zvogëluara) e sidomos për ata që nuk kanë fare koç... Këta tanët kanë kryesisht koç... anatomike, fiziologjike, por u mungojnë apo nuk kanë fare koç... politike, kombëtare dhe vendimmarrëse. Prandaj, ngarendin pas koç... të Klintonit, Obamës, Blerit, disa edhe atyre të Putinit dhe Erdoganit kurse,

kohët e fundit, po shastisen pas koç... të Trampit. Dëshira për të bërë një fotografi me koç... e Trampit është qëllim i karrierës, e arritura sublime, Kilimanxharo i qëllimeve politike, kombëtare dhe strategjike. Vetëm njëri nuk e pati këtë qëllim, maestro i politikës dhe diplomacisë kosovare dhe jo vetëm kosovare, Begjet Pacolli. Ai nuk ishte si Hashimi për t'i çuar mesitë disa muaj më parë vetëm sa për t'ia shtrënguar duart dhe për të bërë një foto me koç...madhin Donald Tramp. Begja, burrërisht, si çdoherë më parë, nuk i doli prapa shpine Trampit, por e ruajtë pasi Trampi doli nga "avdeshanja" (WC-ja), ia zuri pritën dhe ia zgjati dorën duke e përshëndetur dhe duke uruar që Trampi të mos ketë problem me prostatën. Burrërisht e kreu takimin, nuk e zgjati shumë, një shtrëngim duarsh dhe një mirëkuptim me një shikim të shkurtër apo një BLINK (shkrepje) mirëkuptimi. Dhe, Begja, si modest që është, nuk deshë që këtë takim jashtëzakonisht të rëndësishëm për Kosovën, kosovarët dhe mbarë botën demokratike, ta shndërojë në një serial si Utarani por, me një fjali të vetme e informoi mbarë botën demokratike dhe vartësitë e tij në Kosovë: "Një takim miqësor me presidentin Tramp...". B. P. (mos e përktheni në Beograd Petrol), por janë inicialet e idolit tim Begjet (B) Pacolli (P).

A e dini lexues të nderuar kush është në këtë mes Trampi e kush është Trapi?

Konkurs për heronj të rinj të Kosovës: Për festën e ardhshme të Katër Synetive dhe Gjashtë Kanagjeqeve kërkohen emra për heronj të rinj të Kosovës. Kushtet e kërkua dhe që kanë përparësi: ata që nuk e kanë shkrepur asnjë plumb për Kosovën, ata që kanë shërbyer në ushtrinë okupuese, oficerë të OZNËS, KOSIT, UDB-së dhe BIA-së, dezertorë dhe sabotues të luftës së UÇK-së, bijë dhe bija të ish-shqipfolësve jugosllavë dhe serbë, nipa dhe mbesa të Drazh Mihajlit, hajna dhe hajdutë të fondeve të luftës së UÇK-së, si të Trepërqindëshit ashtu edhe Vendlindja Thërret, pobratima të Slobës, jarana të Stanishiqit, berberë të Vuk Drashkoviçit dhe ortakë të biznesit të Goran Rakiçit. Ata që e ndanë Mitrovicën, e çliruan Smederevën, e këndojnë Sirinaça Repën dhe, më në fund, duan të na fusin qepën. Konkurrenca është e madhe, ka vend për të gjithë, heronj dhe heroina, trimëresha dhe azgana, patriotë të sharkisë dhe çiftelisë, dhe ju që jeni bashkëpunëtorë, me traditë, të Jugosllavisë dhe Serbisë. Dhe kushti vendimtar, të jeni kundër shqiptarisë dhe Shqipërisë!

Erdogani: Kemi drejtësi të pavarur, vetëm gjykata vendos për pastorin amerikan

ANKARA, 26 SHTATOR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan deklaroi se fatin e pastorit amerikan, i cili është arrestuar mbi akuza për terrorizëm, duke tronditur marrëdhëniet mes Ankarasë dhe Uashingtonit, do ta përcaktojnë gjykatat turke dhe jo politikanët.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ishte shprehur të hënën se shpresonte që Turqia ta lironte pastorin evangelist, Andrew Brunson, këtë muaj. Ai

ndodhet në arrest shtëpiak që prej muajit korrik, pasi kaloi 21 muaj në paraburgim.

Në një intervistë për "Reuters", teksa ishte në Nju Jork për takimet në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Erdogan tha se çdo vendim për Brunsonin do të merret nga gjykata. "Kjo është një çështje gjyqësore. Brunsoni është arrestuar mbi akuza për terrorizëm. Më 12 tetor do të ketë një tjetër seancë dëgjimore, por ne

nuk e dimë se çfarë do të vendosë gjykata. Politikanët nuk mund të flasin fare mbi verdiktin", tha Erdogan.

Nëse shpallet fajtor, Brunson mund të burgoset për të shumtën 35 vjet, edhe pse ai mohon akuzat. "Si president nuk kam asnjë të drejtë për ta urdhëruar lirimin e tij. Drejtësia jonë është e pavarur. Le të presim dhe të shohim se çfarë do të vendosë gjykata", tha më tej Erdogan.



Trumpi: Brenda katër muajsh zbuloj planin e paqes për Lindjen e Mesme

Presidenti amerikan Donald Trump, gjatë takimit me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanjahu, ka thënë se do ta zbulojë planin e tij për paqe në Lindjen e Mesme brenda katër muajsh

NJU-JORK, 26 SHTATOR - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka pohuar se do ta zbulojë planin e tij për paqe në Lindjen e Mesme brenda katër muajsh. Lajmi vjen nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së gjatë takimit të miliardit me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanjahu. Pikërisht këtij të fundit, numri një i Shtëpisë së Bardhë i ka referuar se "parapëlqen një zgjidhje mes dy shteteve" për sa i takon çështjes palestineze. Ndërkohë, Trumpi u bëri thirrje vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që të punojnë me Amerikën për të siguruar që Irani nuk krijon kurrë bombë bërthamore. Duke kryesuar mbledhjen e Këshillit të Sigurimit për armët e shkatërrimit në masë, Trumpi e mbrojti vendimin e tij për t'i rikthyer sanksionet kundër Iranit, për shkak të, siç tha, sjelljes së tij të keqe. "U kërkoj të gjithë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të punojnë me Shtetet e Bashkuara për të sig-

uruar që regjimi iranian e ndryshon sjelljen e tij dhe nuk krijon kurrë bombë bërthamore", tha Trumpi. Marrëdhëniet SHBA - Iran janë të tensionuara me dekada dhe Trumpi, sipas vëzhguesve, nuk i humbet mundësitë për ta kritikuar Teheranin. ShBA-ja i ka rikthyer sanksionet kundër Iranit pasi është tërhequr nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 midis Republikës Islamike dhe gjashtë fuqive botërore.

Presidenti amerikan, Donald Trump, tha të mërkurën se administrata e tij po planifikon një takim të dytë me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un dhe do të njoftojë për hollësitë e këtij takimi së shpejti. "Do të takohem me kryetarin Kim", u tha Trumpi gazetarëve në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Trumpi tha se data dhe vendi i takimit do të shpallen së shpejti.

Më parë, të mërkurën, sekretari amerikan Shtetit, Mike Pompeo, tha se po planifikon



takimin dhe se ai mund të zhvillohet pas tetorit. "Ne jemi duke punuar shumë për të siguruar që të kemi kushtet e duhura në mënyrë që të arrijmë sa më shumë rezultate. Por shpresojmë se do të jetë së shpejti", tha sekretari Pompeo për rrjetin CBS të mërkurën.

"Mund të ndodhë në tetor, por më shumë gjasa ka pas tetorit", tha ai.

Komentet e sekretarit Pompeo erdhën një ditë pasi presidenti Trump lavdëroi marrëdhënien e tij me Korenë e Veriut, duke thënë në Asamblenë së Përgjithshme të Kombeve të

Bashkuara se kjo ka ndihmuar në zbutjen e tensioneve në Gadishullin Korean. "Raketat nuk po fluturojnë në çdo drejtim, provat bërthamore kanë ndalur dhe disa objekte ushtarake tashmë janë duke u çmontuar", tha presidenti Trump.

Kryeministri japonez, i gatshëm të takohet me Kim Jong Unin

NJU-JORK, 26 SHTATOR - Kryeministri japonez Shinzo Abe, një përkrahës i linjës së ashpër ndaj Koresë së Veriut, thotë se është i gatshëm të takohet me udhëheqësin e Phenianit Kim Jong Un.

Abe i bëri komentet e përpara Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të martën. Ai tha se çdo takim i nivelit të lartë do t'i kushtojë zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të vjetër që lidhet me rrëmbimet e civilëve japonezë nga Koreja e Veriut. "Nga ky vend, në të njëjtën periudhë të vitit të

kaluar, i kërkova me forcë Koresë së Veriut ta zgjidhë çështjen e rrëmbimeve, atë të programit bërthamor dhe raketave. Si dikush që bën apel për zbatimin e plotë të të gjitha rezolutave të rëndësishme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i kushtoj vëmendje të madhe ndryshimeve në Korenë e Veriut. Pheniani ndodhet aktualisht në një udhëkryq dhe ose do ta shfrytëzojë, ose do të dështojë ta kapë mundësinë historike që i është ofruar", tha ai.

Abe tha se ende nuk ka plane për një takim, ndërsa i bëri thirrje

udhëheqësit të Phenianit ta tregojë interesin e tij për një takim mes tyre.

Ndërkohë nuk kanë munguar spekulimet rreth një takimi Abe - Kim. Sipas njoftimeve, udhëheqësi i Phenianit i ka thënë presidentit amerikan Donald Trump, gjatë takimit të tyre në qershor në Singapor, se ishte i gatshëm të fliste me armikun e vet japonez. Të mërkurën pritet që Abe të takohet me presidentin Trump për ta diskutuar shqetësimin japonez rreth fërkimeve në rritje mes dy vendeve për çështje të regtisë.



Recension

AGIM RAMADANI, 'AGIMI I LIRISË' DHE MONOGRAFIA E BEDRI TAHIRIT

Prof. dr. Sabahajdin
CENA

Në frymën e parimit të leximit të një monografie që pritet të dalë në dritë për dëshmorin e kombit, sot "Hero i Kosovës", Agim Rrahim Ramadani, të autorit Bedri Tahiri, kemi nderin ta paraqesim opinionin tonë për heroizmin e Tij dhe për veprën "Agimi i lirisë" si një realizim i suksesshëm, me një qasje të re për këtë personalitet të shquar të historisë sonë.

Luftëtari i lirisë Agim Ramadani, i Rrahimit dhe i nënës Fazile, mbesë e Isa Boletinit, është i lindur më 3 janar të vitit 1960 në fshatin Prekaz i Epërm të Skenderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Skenderaj, në mënyrë që studimet t'i vazhdojë në Fakultetin Xehetaro-Metalurgjik të Mitrovicës, ashtu siç qëndron edhe në monografinë e Bedri Tahirit, ku në 300 faqe të tekstit gjenden edhe detaje të shumta rreth jetës dhe veprimtarisë patriotike të Agim Ramadani.

Agimi si fëmijë i parë kishte shumë ëndrra për ditët kur do të çlirohej Kosova, por kishte edhe një barrë më të madhe, i duhej t'i ndihmonte të et, Rrahimit, në mënyrë që të rriteshin e të shkollohen: Brahimi, Bislimi, Samiu, Fehmiu, Shukrija e Fatimeja, ndërsa xha Rrahimi e kishte vështirë që vetë ta siguronte kafshatën e bukës dhe fëmijërinë e lumtur për të gjithë. Agim Ramadani në çdo hap i gjendej pranë edhe bashkëshortja Sanije, bijë e Krasniqëve, që kujdesej për t'i vënë në dritë vocërrakët: Afërditën, Adnanin, Flamurin dhe Albanin e të gjithë sot janë burra e mbi burrërinë e tyre lëshon dritë edhe monografia e ndarë në shumë pika dhe e pajisur me parathënie në gjuhën shqipe dhe anglishte, ndërsa përveç qasjes së personale shkrimtari Bedri Tahiri vendos edhe opinionet e të tjerëve për heroin Agim Ramadani.

Sipas kësaj Monografie dhe shumë burimeve të tjera, të cilat i shfletoi autori, dëshmorin e kombit Agim Ramadani herët kyçet në veprimtarinë e ilegales së Drenicës me nofkën "Lumi" dhe vepron në çdo segment të distribuimit të materialeve që asokohe mund të gjendeshin në çdo skutë e në çdo odë të Drenicës.


Pjesëtarëve të ilegales nuk u mungonte vullneti në mënyrë që para hundëve të policisë më të egër të Evropës të gjendeshin trakte e pamflete për paralamërimin se ky popull nuk do ta duronte më zgjedhën e robërisë,

vijë kjo narrative të cilën profesor Tahiri e ndjek edhe në shkrimet e tjera kushtuar luftës dhe heroizmit të pishtarëve të lirisë, prandaj edhe në rrafshin organizativ nuk mund të gjendet manifestim gjithëpopullor e të mos ishte në krye të organizimit studenti i dalluar Agim Ramadani i Prekazit, jeta e të cilit i parakalon çdo lexuesi gjatë leximit të kësaj Monografie, të shkruar e mbarështruar me një përkushtim të veçantë.

Gjatë formimit të instrumentit të forcës, edhe sipas këtij autori, që me kohë dhe gradualisht evoluoi në Ushtri Çlirimtare të Kosovës, Agimi kyçet në sektorin e Logjistikës dhe shpesh dhente kufirin e mallkuar Shqiptaro-Shqiptar vetëm e vetëm që në "Kosovën - djep Lirie" me "një ushtri e një bajrak" të sillte sa më shumë "Zjarr - lirie", prandaj edhe me tërë fuqinë që pati dha kontribut të çmueshëm në logjistikën përgatitore e pastaj edhe në front e në prapavijë të luftimeve anembanë Zonës Operative të Drenicës e të Shalës, episode këto të cilat për mrekulli i strukturoi profesor Bedri Tahiri në këtë Monografi.

Kushtet materiale, si pjesë e pandashme e shkrimeve për sajimin e portretit fizik dhe shpirtëror të dëshmorit, sipas autorit, Agimi i kishte më të kufizuara, por në anën tjetër kishte një fizik në harmoni me nevojat e luftës, prandaj edhe me sukses të theksuar i mbaroi të gjitha stërvitjet ushtarake që zhvilloheshin në Shqipëri. Kështu, ai, si i kalitur e i armatosur, menjëherë, në ditët e para të "Marsit të Jasharajve" lidhet me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjendet në çdo front e në krye të shumë aksioneve guerile. Përherë ishte pranë Ilaz Kodrës, Rasim Kiçinës, Fehmi Lladrovci, sot të gjithë dëshmorë të kombit e Sami Lushtakut, Rrahman Ramës, Brahim Gjakës, Ragip Jasharit, Zenun Kodrës prandaj edhe sot të gjithë e kujtojnë dhe e përkujtojnë me pietet të lartë, andaj edhe autori i kësaj monografie momenteve të këtylla u kushton një hapësirë normale për një njohës të ngjarjeve gjatë ditëve të luftës.

Në ditën e përjetësimit, kur zhvilloheshin luftimet e përgjakshme në Ashlan dhe përreth Qyqavicës në përgjithësi, kur morën përjetësinë edhe dëshmorët: Sadullah e Avni Dibrani, Mustafë Shyti e Bislim Imeri, Enver e Murat Haliti, komandantët Fehmi e Xhevë Lladrovci, dr. Lec Gradica e Vesel Demaku, Fatime Hetemi e Shefqet Zeka, Valdet Xhemaili e Afrim Hajdaraj etj., luftëtari i lirisë Brahim Gjaka me bashkëluftëtarë, arriti për ta



tërhequr trupin e pajetë të Agimit dhe banorët e Ashlanit së bashku me luftëtarët e lirisë ia bënë përcjelljen e fundit për në përjetësi Agimit më 24 shtator të atij viti në fshatin Ashlan dhe sot trupi i pajetë i është bashkuar të gjithë dëshmorëve në Shipol të Mitrovicës, ndërsa e kaluara e Agimit, sot "Hero i Kosovës" shtrihet nëpër kapitujt e nënkapitujt e monografisë "Agimi i lirisë" të Bedri Tahirit.

Për kolonel Agim Ramadani e Prekazit janë bërë shumë shkrime në të cilët është skalitur portreti fizik dhe shpirtëror që i ngjante një Kamani të Naim Frashërit, ndërsa emrin e Agimit mbante kazerma e Brigadës 342 të Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Mitrovicë, e familja e Agimit përveç shumë relikteve të tjera, ruan edhe një ditar të luftëtarit që nesër mund të jetë lëndë për historianët tanë, aty mund të gjejnë frymëzime edhe poetët, kompozitorët, këngëtarët, piktorët, skulptorët dhe kineastët. Edhe familja e xha Rrahimit gjatë netëve kur mbijetesa modeste, pas punëve të shumta e të rënda, i lejon ca çaste për të evokuar kujtime, rrëfen me krenari për Agimin dhe të gjithë Agimët që ranë në Agimin e Lirisë dhe të Pavarësisë së Kosovës, e cila tashmë është shtet, e Agimave u duhet një përkujdesje më e madhe institucionale, familjarëve të tyre u duhen vizitat e pjesëtarëve të institucioneve në mënyrë që të gjejnë sadopak ngushëllim për atë se çdo gjë që patën ia dhanë Kosovës.

Në bazë të njohurive personale të dëshmorit të propozuar dhe të aprovuar për titullin "Hero i Kosovës" del përfundimi se kontributi i personalitetit-lëndë e kësaj monografie, mbetet i

pakontestueshëm në rrafshin organizativ të celulave të para të organizimit të rezistencës së armatosur në arealen luftarake të Drenicës dhe në Zonën Operative të Shalës, ndërsa betejat e filluara në orët e para të "Marsit të Jasharajve" janë ndër ndërmarrjet më të përgjakshme por edhe më vendimtare për kalendarin luftarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ato ditë, e që mbeten ndër ditët më krenare për Kosovën, Ushtria Çlirimtare e përbërë prej djelmohave të komandantit legjendar Adem Jasharit, prandaj edhe Agim Rrahim Ramadani u bë personalitet me ndikim për retardimin dhe avancimin e formacioneve të Drenicës e të Shalës, prandaj edhe kapitujt si: Historiku i Skenderajt, Prekazi, Prekazi i Epërm, Trungu rrënjëthellë, Fëmijëria dhe rinia, Dashuria për këngën, Librin dhe armën, Heronjtë e nëntokës, Themelues i LDK-së në Shipol, Pajtimtar gjaqesh e ngatërresash, Përfaqësues në Kongresin e Parë të BSPK-së, Në krye të organizimeve, Kur ëndrra iu bë realitet, Këshilli i Emergjencës, Frymëzime, refletime dhe synime, Akti i dytë i dramës jashariane, Intelektuali ka një Zot: të vërtetën, një "Bibël"- popullin, Agimi - pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Organizimi i jetës së brendshme në Ushtri, Nga ilegaliteti në frontet e luftës, Guerilasi me flatra dragoi, Sy me sy me vdekjen, Trimat jetojnë pas vdekjes, Dëshmorin e Gurrabardhit, Hëna sypërplotur dhe varret binjake, Ankthe netësh gjatë plojes në Qyqavicë, Krimi që tundi botën, Po shkoj te komandanti im, Varrimi, riavarrimi dhe nderimi, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe mendimet

e të tjerëve për Agim Ramadani, begatojnë faqet e kësaj Monografie dhe mundësojnë leximin e lehtë e të këndshëm për lexues të çdo moshe. Meritë e veçantë e kësaj monografie të prof. Bedri Tahirit, është thyerja e klisheve dhe formulësimeve epike që u bënë rutinë e kohëve të fundit, prandaj qasja në shkrimet për Agim Rrahim Ramadani, është kahe më e re e qasjeve në neopozitivizmin historik për çka u dëshmuua profesor Tahiri, përveç këtij shkrimi, edhe në shkrimet e tjera për Drenicën dhe Shqiptarinë. Autori edhe këtë tekst e pajisi me fotografi, harta e skica, e pajis me faksimile dokumentesh çka e sajoi edhe brumin historik edhe për historianët dhe studiuesit e ardhshëm të historisë, prandaj autori vë një listë të gjatë të burimeve dhe të literaturës së konsultuar, mbi 70 vepra (artikuj) e që forcojnë nivelin shkencor e hulumtues të një historiani të mirëfilltë.

Së këndejmi, gjatë leximit dhe menjëherë pas përfundimit të procesit të leximit të kësaj monografie, na sajohen imazhet e parakalimit të luftëtarëve të lirisë në krye të të cilëve gjendet edhe heroi i kësaj monografie, Agim Rrahim Ramadani, emri i të cilit sot shkëlqen anembanë Kosovës, ndërsa shtatorja i bën hije e nder vendit e kombit, dhe: "-Pse nuk ike Sylë, lum nana? -Kesh pak lig e m' dhimti kama. Me pas ik's' m'u kish knu sot kanga!"

**Lavdi Dëshmorëve të Kombit!
Lavdi Agim Rrahim Ramadani!
Suksese të reja në shkrime, prof.
Bedri Tahiri!
Rahovec, më 5 shtator 2018**

E rrallë

Gamilja 'fluturon' gazetaret

Gazetari Thuku Kariuki do t'i jepte lajmet nga Samburu në Kenia kur vendosi të ulet në kafshën e mërzitur. Në pamjet e filmuara Thuku përplaslet i pari në tokë dhe sipër tij bie ndihmësi. Nuk patën përleshje me gamiljen që u qetësua nga dy burra të tjerë. Fatmirësisht, asnjëri nuk pati ndonjë lëndim serioz për ta.



BARSOLETA E DITËS



Polici: A e di ti se të vozitësh 200 km/h është e kundërligjshme?
Shoferi: Po, e di, qysh s'e di!
Polici: Po pse nuk ndaloje kur të ndiqja, pra?
Shoferi: Pasha Zotin, zotëri polic, mendova se po ke qejf të shtyresh me mua!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



FOTO E DITES



Një aeroplan shihet duke fluturuar para një hëne të plotë në Sydney, Australi. /AFP/

E jashtëzakonshme

Plazhi i populluar nga breshkat

Plazhi Versova në Mumbai është mbushur përplot me breshka. Një ekip vullnetarësh ka nisur t'i largojë ato. Një studim bërë kohën e fundit ka gjetur edhe 299 vende (plazhe) të tjera që janë bërë fole e breshkave anembanë botës, duke dëshmuar se ato janë duke u rikuperuar ngadalë nga zhdukja e afërt që rrezikonin.



Në ora 20:00 dhe 22:00 "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.



DEMI

Mos ua ktheni në të njëjtën monedhë personave që janë kundër jush dhe që ju akuzojnë për gjëra pa vlerë.



BINJAKËT

Kjo ditë do të jetë më e vështirë sesa e mendonit për ju sepse një gjë e papritur që do t'ju ndodhë do ta prishë gjithë rregullin e krijuar.



GAFORRJA

Disa probleme të vogla në punë mund të krijojnë keqkuptime me partnerin sot. Është mirë t'i ndani çastet e punës nga ato të relaksit.



LUANI

Personat që ju duan do të përpiqen t'ju këshillojnë të hiqni dorë nga një sipërmarrje mjaft e rrezikshme për ju.



IRGJËRESHA

Sot me ato që po thoni po lini të kuptohet që jeni shumë të ndjeshëm karshi një personi të caktuar. Ndjenjat nuk mund t'i fshihni.



PESHORJA

Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për ta mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.



AKREPI

Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj, sot mundohuni t'i qartësoni disa situata të dyshimta.



SHIGJETARI

Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



BRICJAPI

Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku, nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



UJORI

Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot, mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtton për të gjitha projektet tuaja.



PESHQIT

Keni prioritete, por nuk duhet asnjëherë t'i vendosni ato përpara familjarëve tuaj. Një pjesëtar i familjes po kërkon suport.

Gwyneth Paltrow do të martohet më 29 shtator



Gwyneth Paltrow dhe Brad Falchuk janë gati të betohen për dashurinë e përjetshme. Pas disa muajsh thashethemesh dhe spekulimesh, mediet amerikane japin datën e 29 shtatorit si të sigurt. Çifti do të thotë "po" përballë miqve dhe të


afërmve me një festë në shtëpinë e tyre në Hamptons, ndërsa ndjekësit martesën e tyre mund ta shohin në rrjetet sociale përmes hashtag #TheFaltrows. Kjo është martesë e dytë për të, pas dasmës së fshehtë me Chris Martin në vitin 2003.

Federica Pellegrini, notarija që i bën modelet ta kenë zili



Notarja italiane Federica Pellegrini ka dalë në pasarelë për koleksionin "My-kini", e Raffaella D'Angelo dhe këtë herë dukej më e qetë se kurrë. Federica Pellegrini ka ecur për-

para publikut shumë e vendosur, me një pamje të sigurt sikur të ishte në pishinë. Modelueset duhet ta kenë shumë zili, sepse i ka lënë një hap mbrapa me profesionalizmin që ka treguar.



Bella Hadidi, mahnitëse me fustan transparent

Bella Hadid pushtoi pasarelët nga Nju Jork në Milano. Supermodeluesja dukej mahnitëse derisa po largohej nga hoteli i saj në Paris mbrëmjen e së martës. Mbretëresha e pasarelave mbante veshur një

fustan të zi transparent që i vinte në pah trupin e saj të përkryer, shoqëruar me një çantë leopardi. Jo vetëm në pasarelë, por edhe në jetën e përditshme Bella di ta ndjekë trendin e veshjeve dhe të shkëlqejë.

"Versace" blihet nga Michael Kors me një shumë marramendëse



"Versace", shtëpia italiane e modës, e themeluar nga Gianni Versace 40 vjet më parë, do të blihet nga Michael Kors. "BBC" ka raportuar se shtëpia amerikane e

modës është pajtuar për blerjen e firmës italiane në një marrëveshje me vlerë rreth dy miliardë dollarë. Familja "Versace" ende zotëron 80 për qind të kompanisë.

Kur arti zbuste turmat

Ollga Shuraja do t'i bashkohej thirrjes së Ministrisë së Shtypit dhe Propagandës e Kulturës Popullore për aktorë të rinj më 17 maj të vitit 1945. Pasi kishte provuar Luftën Nacionalçlirimtare si partizane, ajo kërkon një tjetër sfidë në jetën e saj teatrin. Emri i saj është i pari në listën e gjatë të emrave që i kanë thënë po thirrjes së Partisë. Ajo nuk mund ta mendonte se edhe pse jetëgjatësia e saj në teatër do të ishte e shkurtër, do të ishte aktorja e parë femër në teatër. Më 30 maj 1945, regjisor i Sokrat Mio i jep asaj një rol në shfaqjen "Topazi". Dosja e saj në teatër mban numrin 1. Aktori Lazër Filipi, i cili ka luajtur rolin e maxhordomit të "Topazi", e kujton shumë mirë atë shfaqje. Në fakt, është i vetmi protagonist në jetë i kësaj shfaqjeje. "Unë

ndryshme të Shqipërisë janë thirrur elemente që pak a shumë kanë njohuri mbi artin dramatik, e kryesisht shumë talent. Prandaj Ministria e Shtypit e Propagandës dhe Kulturës Popullore, ju thërret dhe juve për të dhënë kontributin tuaj në këtë grup teatral, kundrejt rrogës fikse mujore. Shtojmë se përveç kësaj rroge do të keni dhe të drejtën e përqindjes nga çdo shfaqje që do të bëjë grupi teatral. Jemi të bindur se nuk do të kurseheni për të dhënë kontributin tuaj në këtë drejtim sidomos duke marrë parasysh rolin e madh edukativ, që loz për turmat arti dramatik. E drejta e rrogës do të merret më 1 maj 1945. Deri më 20 të këtij muaji duhet të paraqiteni në Drejtorinë e Kulturës Popullore për të marrë instruksionet e





dhe Ollga vinim nga teatri partizan. Unë isha i rrethit të Tiranës, ajo të Përmetit. Ollga ka qëndruar në teatër deri nga viti 1946 dhe më pas është larguar me dëshirën e saj, kujton Filipi. Në listën e gjatë të aktorëve që i janë bashkuar nis-mës është dhe emri i aktorit Mihal Popi. Ai vinte nga një aktivitet në teatër që në vitet 1924, me grupet amatore. Në vitin 1932 kishte krijuar grupin e vet teatral. Ka interpretuar mbi 40 role, ku ndër më të suksesshmit janë roli i prefektit Qazim Mulleti "Prefekti", Anton Antonoviçi "Revizori", Falstaf "Gratë gazmore të Uindsorit", Zhurdeni "Borgjezi fisnik", senatori Lington etj. Ai është nderuar me titullin e lartë "Artist i Popullit". Më 1966 del në pension, por nuk u shkëput nga skena. Behije Çela është një tjetër aktore që i është bashkuar thirrjes. Por çfarë thuhet në shkresën e gjetur në Arkivin e Shtetit si akt themelimi: "Ky dikaster, për t'i dhënë zhvillim më të gjanë e me baza më të shëndosha artit dramatik në Shqipëri, mendon të krijojë një grup qendror teatral. Për këtë qëllim nga qytete të

duhura", thuhet në deklaratën e cila nënshkruhet nën thirrjen "Vdekje fashizmit, liri popullit". Që pas këtij akti themelimi historia e teatrit është gati gjashtëdhjetë e pesëvjeçare me një repertor prej 500 premierash nga dramaturgjia kombëtare dhe ndërkombëtare duke nisur që nga korifentët e antikitetit për të vijuar me autorë si Shekspir, Molier, Çehov, Breht, Ibsen dhe deri te më bashkëkohorët si A. Miller, E. De Filippo, T. Dorts, E. Albee e shumë e shumë të tjerë. Shfaqja e parë është komedia "Topazi" nga Marcel Pagnol me regjinë e Sokrat Mios u quajt si "shfaqja themeluese e TK". Për herë të parë në Shqipëri për teatër është folur në periudhën e Rilindjes Kombëtare në fund të shekullit XIX. Në vitet '45-'56 shteti shqiptar u përpoq ta orientonte TK, së paku në tri drejtime: sigurimin e një repertori me drama të "realizmit socialist" me autorë të vendeve të Lindjes. Përpos repertorit me ndikim politik, spikasin premierat nga dramaturgjia botërore: Revizori - Gogol, Othello - Shekspir, shërbëtori i dy zotërinjve - K.

Goldon. Në vitet 1956-1965 flitet për një teatër vërtet profesionist ku radhët e të cilët u shtuan me skenografë, regjisorë dhe aktorë të kualifikuar. Por do veçojmë edhe se në repertorin e kësaj periudhe spikasin vepra madhore nga dramaturgjia botërore si: Intrigë dhe Dashuri - Shiller, Hamleti - Shekspir, Borgjezi Fisnik - Molier, Xhaxha Vanja - A. Çehov, Mbreti Lir - Shekspir vitet '65-'72 dallohen nga trajtimi i dramaturgjisë kombëtare si element kryesor në repertor dhe kufizimi gradual i veprave të shquara nga dramaturgjia botërore. Vitet 1972-1985 dallohen për nga politizimi i tejskajshëm i repertorit të Teatrit Kombëtar, ndëshkimin dhe largimin nga skena të disa prej regjisorëve, dramaturgëve dhe aktorëve si modernistë, si dhe pakësimin e repertorit dhe të premierave. Vitet 1985-1992 janë vitet e fund-diktaturës, deri më 1990

kur përmbysset ajo dhe kemi fillimet e lirisë, nga ku vihen re: - një prani më e gjerë e repertorit të huaj, -guximi për të prekur tema tabu, eksperimentet e para dhe shija e paprovuar e autorëve të ndaluar. Mund të veçojmë disa premiera: Vdekja e njëj komisioneri - A.Miler, Romeo dhe Zhulieta - Shekspir, Zbutja e kryeneçes-Shekspir, Frikë dhe mjerim në rajhun e tretë -B.Breht, Dhelpra dhe rrushtë - G.Figuero, Rikardi i tretë - Shekspir. Vitet 1992 - 2010 shënojnë vitet e ndryshimeve strukturore rrënjësore në TK, ku veçohen si dukuri: - aplikimi i metodologjive të fundit teatrore, - zotërimi thuajse absolut i repertorit nga pjesët e huaja, kryesisht komedi dhe tragjikomedi, pakësimi në mënyrë të ndjeshme i autorëve shqiptarë, - hapja e hapësirës për ngritjen e kompanive private. Disa nga premierat - "Dy

zotërinjtë nga Verona" - Shekspir, "Fernando Krafi me ka shkruar një letër" T.Dorst, "Don Zhuani" Molier, "Njeriu, virtyti, kafsha" "Gjashtë personazhe kërkojnë autor" - L. Pirandello, "Armiku i Popullit" - H.Ibsen, "Filumena Marturano" - De Filippo, "Gratë Trojane" nga Euripidi, "Elektra" nga Sofokliu, "Mbreti po vdes" - E. Yonesco, "Portreti i Dorian Greit" - O. Wailde, "Pamje nga ura", "Shtrigat e Salemit"- A. Miller, "Kush ka frikë nga Virginia Wolf"- Eduard Albee. Nga dramaturgjia kombëtare "Stinë e mërzitshme në Olimp" I.Kadare, "Gomonet" M.Luarasi, "Babai" R. Pulaha, "Kambanat e Muzgut" T. Laço, "Korbi i Bardhë" M.Luarasi, "Alegreto Albania" S. Çapaliku "fituese e çmimit të parë të kritikës në Bienalen e Wisbadenit, Gjermani - qershor 2010, "Darka e Gabuar" I. Kadare, "Një Tablo Absurde" E.Hysi. (gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ALAVES - GETAFE

GG

VALLADOLID - LEVANTE

3+

EMPOLI - AC MILAN

2

20-vjeçari Alidema: Do t'i shënoj 20 gola

Festim Alidema është sulmues i Llapit dhe aktualisht është 20-vjeçar por, falë formës së mirë që ka në këtë kampionat, ai beson se do të shënojë të paktën 20 gola për skuadrën nga Podujeva. "Kam besimin e trajnerit dhe klubit, por jam edhe në formë të mirë dhe nëse nuk pësoj ndonjë lëndim, normalisht se do të shënoj 20 gola", ka thënë Festim Alidema

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Festim Alidema është një nga lojtarët më të ri dhe me perspektivë të madhe në futbollin e Kosovës. Në gjashtë javët e para futbolli në fjalë ka shënuar katër gola dhe është golashënuesi më i mirë për Llapin dhe i dyti në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pas Alban Shillovës së Flamurtarit. Alidema, i cili është 20-vjeçar, të mërkurën për "Epokën e re" ka thënë se në këtë kampionat do të shënojë të paktën 20 gola. "Kam besimin e trajnerit dhe klubit, por jam edhe në formë të mirë. Nëse nuk pësoj ndonjë lëndim, normalisht se do të shënoj 20 gola", ka thënë Alidema, i cili ka karrierën e ka nisur në moshën gjashtëvjeçare.

Në ekipin e parë Alidema ka debutuar në skuadrën e Vllaznisë së Pozharanit, nga skuadër e cila në janar të vitit të kaluar iu bashkua Llapit si një transferim cilësor për të ardhmen. Mirëpo me angazhimin e trajnerit Bylbyl Sokoli, futbolli sulmues në këtë kampionat e ka pasur besimin maksimal të "Profes" dhe deri tash e ka shpagueur këtë besim, duke qenë ndër lojtarët më të mirë në skuadrën e Llapit. Në ndeshjen e fundit kundër Lirisë, ai shënoi tre gola për Llapin. "Këtë sezon e kam filluar me shumë përkushtim dhe punë. Jam në formë të mirë dhe besoj se do të vazhdoj deri në fund kështu. Po ndihem shumë mirë që e kam besimin e tra-



nerit dhe për këtë po jap maksimumin që të shpaguej në secilën ndeshje", ka deklaruar ai.

Aktualisht skuadra e Llapit pozicionohet e dyta në renditjen tabelore me 13 pikë, një pikë më pak se skuadra e Feronikelit që është lider. Alidema ka konfirmuar se synim i skuadrës nga Podujeva është titulli dhe dalja në arenën ndërkombëtare.

"Synimet e Llapit në këtë kampionat janë të shpallimi kampionë e më pas të luajmë në Evropë. Nuk është synim i lehtë për t'u arritur, pasi ka shumë ndeshje deri në fund të kampionatit dhe rivaliteti do të jetë i madh në garën për titull", ka përfunduar ai. Ndeshjen e radhës, në xhiron e shtatë në elitë, Llapi do të zhvillojë ndaj KEK-ut.

SHKURT

Ademi dhe Salihu sot takohen me Infantinon

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, bashkë me sekretarin e përgjithshëm, Eroll Salihu, sot (e enjte) do të takohen me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. Takimi do të zhvillohet në selinë e FIFA-s dhe fillon nga ora 13:00. "Ftesa nga i pari i FIFA-s është shumë domethënëse për mua dhe FFK-në, pasi shpreh respektin dhe mbështetjen që FIFA e ka për neve. Ndaj bashkë me sekretarin Salihu do ta shfrytëzojmë rastin ta falënderojmë për mbështetje dhe njëherësh ta informojmë për rrjedhat e zhvillimit dhe për realizimin e projekteve në futbollin në Kosovë. Si dhe do të kërkojmë përkrahje edhe më të madhe përmes projekteve për zhvillimin dhe përparimin e mëtutjeshëm të futbollit në Kosovë, duke marrë për bazë nevojat tona", ka thënë Ademi.

Zvicra refuzon ofertën e Abaramovichit

Roman Abramovich dy vjet më parë kërkoi ta merrte të drejtën e rezidencës në fshatin Verbier në Zvicër. Por kërkesa e manjatit rus u refuzua nga autoritetet zvicerane, ku nuk doli ndonjë arsye bindëse. Por është "The Guardian" që ka hedhur dritë mbi këtë çështje. Sipas medieve angleze, presidenti i Chelsea shihet si një person me rrezikshmëri shoqërore dhe ndërkombëtare për Zvicrën. Me sa duket, Abramovich dyshohet të jetë i lidhur ngushtë me një rrjet të madh pastrimi parash dhe krimi të organizuar. Kështu rusi ka hedhur në veprim të gjithë avokatët e tij për zbardhjen e çështjes dhe, sipas tyre, thuhet se: "Çdo skenar, sipas të cilit Abramovich është i përfshirë në pastrim parash apo krim të organizuar, është fals dhe mashtrim publik. Roman Abramovich nuk është akuzuar kurrë për asnjë nga këto krime dhe nuk ka asnjë precedent penal".

Lillardit kërkon titullin kampion në NBA

Imazhet e fundit nga sezoni i kaluar shfaqin Damian Lillard të dalë me kokulur pas humbjes 4-0 në serinë e raundit të parë të "play-off"-it kundër New Orleans Pelicansit. Një dështim i vështirë për t'u përthypur, duke marrë parasysh edhe sezonin e mirë që Portland zhvilloi. Këtë e pranon edhe vetë Lillard. "Ishte një humbje e rëndë, sidomos për mua, si lider i skuadrës. Kur humb, është gjithmonë faji yt, e në atë rast më duhet të pranoj se ishte e vërtetë. Nuk i kam harruar ende ato ndeshje, e nuk kam ndërmend t'i harroj. Por, nuk do të dorëzohem, pasi këto përvoja të forcojnë më shumë", ka thënë Lillard. "Kur isha në gjimnaz shënoja 35-40 pikë përpara trajnerëve më të mirë të kolegjeve si Roy Williams apo Mike Krzyzewski dhe nuk më rekrutonte askush. E njëjta gjë edhe në kolegji, pasi thoshin se nuk kisha kundërshtarë të nivelit të duhur, sepse luaja në Lehigh. Edhe në NBA ishte kështu. Ëndrra ime është të fitoj NBA dhe të jem MVP i ligës", ka shtuar ylli i Portlandit.

Besim Hasani mori pjesë në takimin e Komisionit të KOE-s

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka marrë pjesë në takimin e parë të Komisionit të Komitetit Olimpik Evropian (KOE) për Lojërat Olimpike. Presidenti Hasani është anëtar i këtij

Komisioni, bashkë me presidentë dhe sekretarë të përgjithshëm të komiteve të tjera evropiane. Në takimin e mbajtur të martën në selinë e ANOC-ut (Asociacioni i Komiteteve Olimpikë Kombëtare) në Lozanë të Zvicrës, Komisioni

propozoi disa rekomandime për Bordin Ekzekutiv të KOE-s dhe të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON) lidhur me efikasitetin e Lojërave Olimpikë "Tokyo 2020", sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me transportin, akreditimet,

Fshatin Olimpik etj. Po ashtu, Komisioni diskutoi edhe për shumë sfida të tjera me të cilat ballafaqohen organizatorët e Lojërave Evropiane dhe Festivaleve Olimpikë, duke ndarë mendimet e tyre për t'i gjetur zgjidhjet e duhura.

Sekretarja e përgjithshme e ANOC-ut, Gunilla Lindberg, ndau edhe informacione të dobishme në lidhje me Lojërat Olimpikë Verore për të Rinj, "Buenos Aires 2018", që nisin javën e ardhshme, si dhe Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020".

Williamsi tërhiqet nga turneu i Pekinit

Uashington, 26 shtator - Serena Williams ka vendosur të mos luajë më asnjë ndeshje këtë vit, duke u tërhequr edhe nga turneu Masters i Pekinit, ku ishte regjistruar dhe që nis më 1 tetor. Tenistja 36-vjeçare, fituese

e 23 grand slameve në karrierën e saj, e mbyll kështu këtë vit me 24 ndeshje të luajtura, 18 fitore e 6 humbje. Ajo u rikthye në fushë 8 muaj pas lindjes së vajzës, duke dalë edhe në finale të dy grand slameve,

"Wimbledon" dhe "US Open", por pa i fituar dot ato. Kjo tërheqje e ish-numrit 1 në botë duket se vjen pas polemikave të shumta që ajo pati pas finales së humbur në "US Open", ku debatoi ashpër me gjyqtarin

Carlos Ramos, të cilin e akuzoi edhe për racizëm. Por tenistja u shpreh se tani ajo do t'i nisë përgatitjet për sezonin e ri, ku synon të jetë kompetitive që në janar, kur zhvillohet "Australian Open".



Gashi: Do të ketë pjesëmarrje më aktive në sport



PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së aktiviteteve në kuadër të Javës Evropiane Sportive, të cilat organizohen nga Federata e Sporteve Universitare të Kosovës. Ministri Gashi është shprehur i kënaqur që merr pjesë në ceremoninë e hapjes së këtyre aktiviteteve. "Federata e Sportit Universitar ka luajtur rol kyç për implementimin e strategjisë sonë të re të sportit e cila ka një objektiv të qartë në kuadër të objektivave të tjera e cila ka të bëjë me masivizimin e sportit në Kosovë. Nga statistikën që kemi në

Kosovë ka pjesëmarrje të ulët të qytetarëve në ngjarje sportive dhe kjo neve na bënë ta ndryshojmë strategjinë e sportit në mënyrë që të sigurojmë pjesëmarrje më aktive në sport. Ne duhet ta rrisim pjesëmarrjen e qytetarëve tanë në ngjarje sportive dhe të sigurojmë pjesëmarrje të drejtpërdrejt në sport. Në bashkëpunim me Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës besoj se do ta rrisim përqindjen e pjesëmarrësve gjatë vitit 2019 në aktivitete sportive", ka thënë Ministri Gashi. Ndërkaq presidenti i sportit universitar të Kroacisë, Zrinko Custonja, ka deklaruar:

"Fuqia e sportit është gjuhë universale që i lidh të gjithë. Sporti ka fuqinë t'i bëjë njerëzit bashkë dhe ta bëjë komunitetin më të mirë. Kosova ka sportistë të mrekullueshëm dhe e ardhmja e sportit është e ndritur, mirëpo Kosova duhet të jetë më aktive". I pranishëm ishte edhe presidenti i Federatës Sportive Universitare të Shqipërisë, Besnik Veliu, cili ka vlerësuar se Java Evropiane e Sportit pakufi përfshin të gjitha moshat dhe se është një javë sensibilizuese që duhet të përfshihen të gjitha shtresat e shoqërisë për një jetë më të shëndetshme.

SHKURT

Dështon takimi Low - Ozil

Ka dështuar takimi në mes të trajnerit të Kombëtares së Gjermanisë, Joachim Low dhe ish-lojtarit të kësaj kombëtare, Mesut Ozil. "Bild" raporton se trajneri Joachim Low dhe menaxheri Oliver Bierhoff shkuan në qendrën stërvitore në skuadrën e Arsenalit, por ata nuk u lejuan të hyjnë brenda dhe në këtë mënyrë dështoi takimi me mesfushorin Ozil. Ky i fundit publikisht ka bërë me dije tërheqjen nga Kombëtarja e Gjermanisë dhe tentimi për të rikthyer nuk pritet të ketë sukses.

Guardiola zbulon "Iniestën" e Cityt

Manchester City zbulon një talent, të cilin në Angli nuk ngurrojnë ta krahasojnë me Andres Iniestën. Fil Foden është vetëm 18-vjeçar, ndërsa shkëlqeu në ndeshjen e Kupës së Ligës, të fituar 3-0 përballë Oxfordit. Talenti i rritur në Akademinë e Cityt u përfshi në aksionet e golave të shënuar nga Jesus dhe Marhez, përpara se ta festonte golin e parë zyrtar me fanellën e "Citizens". "Nuk do të them se Fil do të bëhet Iniesta i ri, sepse Andes është ndër lojtarët më të mirë që kam parë dhe nuk dua ta vendos djalosin në presion. Natyrisht se Foden ka kualitetin për të luajtur në 10 vjetët e ardhshëm te City", ka thënë Guardiola.

Trajneri i Uruguait refuzon statujën në nder të tij

Oscar Tabarez rezultoi se është mjeshtri i modestisë. Trajneri i përfaqësueses uruguaiene ka refuzuar propozimin e bërë nga Bashkia e Montevideos për vendosjen e një statuje të teknikut 71-vjeçar në qendër të qytetit, pikërisht për ta nderuar atë. Oscar Tabarez është një rekordmen absolut për sa i përket drejtimit të një kombëtareje të vetme, pasi është i vetmi trajner që ka qenë në stolin e Uruguait në 4 edicione të Kupës së Botës: në vitin 1990, 2010, 2014 dhe 2018. Tani ai është gati të vendosë rekorde të reja, por pa nderime speciale, siç është rasti i ngritjes së statujës së tij në qendër të kryeqytetit uruguaiian. Janë vetë drejtuesit e Bashkisë së Montevideos që kanë konfirmuar gjithçka, duke shpjeguar edhe arsyen e refuzimit të Tabarezit në lidhje me këtë çështje. Sipas tyre, Tabarezi e refuzoi ngritjen e statujës, pasi do ta shkatërronte frymën e bashkimit, të cilën po kërkon ta krijojë dhe inkurajojë te përfaqësuesja uruguaiiane.

Bayerni e gjënë zëvendësuesin e Neuerit

Bayern Munchen e ka identifikuar zëvendësuesin e portierit Manuel Neuer. Mediet gjermane raportojnë se skuadra kampione nga Bundesliga ka shfaqur interesim për transferimin e portierit të Benficas, Odisseas Vlachodimos. Ky i fundit është kërkuar edhe nga Liverpooli. Futbollisti gjerman me prejardhje greke së fundmi kërkohej edhe nga skuadra e Liverpoolit.

Wengeri: Ende nuk jam pensionuar

Ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, ka insistuar se ai nuk e ka marrë vendimin për t'u pensionuar nga futbolli, por është ende i pasigurt se kur do të kthehet përsëri në pozitën e trajnerit të ndonjë klubi. Strategu francez u largua nga Arsenali pas një periudhe 22-vjeçare. "Të jem i sinqertë, për momentin nuk kam menduar për të punuar në ndonjë klub sepse i kam thënë vetes se gjatë këtyre muajve të parë nuk do të marrë asnjë vendim", ka thënë Wengeri, duke shtuar: "Kështu që nuk jam shqetësuar për këtë gjë, nuk kam menduar fare. Por, jo, nuk jam i pensionuar. Nëse do të kërkoja pensionin, do ta kisha bërë që një kohë të gjatë. Unë do t'i mbush 69 vjeç në tetor".

Ronaldo: Të gjithë do të flasim për Valladolidin

SAO PAOLO, 26 SHTATOR - Ish-sulmuesi i Brazilit, "Fenomeni" Ronaldo, dëshiron ta bëjë Real Valladolidin një skuadër të madhe për futbollin evropian. Legjenda e Real Madridit dhe Interit bleu pjesën më të madhe të aksioneve të ekipit në fillim të muajit. Pas shakasë në lidhje me rolin e tij si president i bordit drejtues, duke thënë se është shumë më e vështirë se jeta e tij e mëparshme si lojtar, 42-vjeçari zbuloi planet e tij për klubin. "Jam shumë i lumtur dhe do të jap gjithë përvojën time, të gjitha ëndrrat e mia, gjithë emocionet e mia për këtë projekt që të jetë i suksesshëm", ka thënë ai. "Këtu nuk është në lojë vetëm reputacioni i klubit, por mbështetja e tifozëve dhe shpresa e gjithë qytetit. Ne presim ta bëjmë të gjithë vendin të flasë për ne, pse



jo edhe për Evropën. Ne kemi një ëndërr dhe kjo është ajo ku duam të jemi (Evropa). Kështu që kemi shumë punë përpara dhe jemi gati për ta bërë këtë",

ka deklaruar Ronaldo. Valladolidi momentalisht renditet në vendin e parafundit në tabelë, në kërkim të fitores së parë në kampionat.

Pse “Financial Times” merret me Cristiano Ronaldo!



Andrea Agnelli dëshiron të shfrytëzojë “markën CR7” për të ndryshuar modelin e biznesit të Juventusit, duke e shndërruar atë në një klub global të të ardhurave dhe me kontrata shumë të pasura nga sponsorët. Për ta bërë këtë, duhet të kapërcejë dobësitë e futbollit italian: pak të drejta televizive dhe pak apel ndërkombëtar. Çështja sportive e shekullit është në faqet e gazetës më prestigjioze të financave dhe ekonomisë së kontinentit të vjetër. Me “Big Read” të tij të së dielës, ‘Financial Times’ rindërton dhe analizon “faktin” më të komentuar të futbollit të të gjitha kohërave: kalimin e Cristiano Ronaldos nga Real Madridi në Juventus, një marrëveshje që mund të errësojë çdo ndeshje të kampionatit botëror të Rusisë dhe ndonjë goditje tjetër të tregut të futbollit të verës 2018. Duke provokuar: por me të vërtetë ishte një marrëveshje për ekipin e Andrea Agnelli? Ft e për-

cakton atë si një bast. Nga 100 milionë euro, ato të paguara në Florentino Perez, plus 340 milionë për katër stinët, paga e kampionit.

Pra, shifra të mëdha, duke pritur për të mbledhur me të vërtetë, kur kampioni do ta ketë bërë Juventusin një “klub global”, një udhëheqës futbollit botëror. Për sa u përket fitoreve dhe imazhit. Por, gjithashtu (dhe mbi të gjitha) të pasqyrave financiare dhe të ardhurave.

“Efekti Ronaldo” dhe modelet e menaxhimit

Nëse, siç shkruan Ft, Juventusin nuk ka nevojë për CR7 të dominonjë kampionatin italian, sipas menaxherëve të tij lojtari paraqet një mundësi financiare të pashembullt, e cila mund të përmblihet me shprehjen “Efekti Ronaldo”. Gazeta angleze shkruan se klubi i Torinos me këtë

blerje synon të ndryshojë modelin e saj të biznesit: sponsorët nuk do të kërkojnë Juventusin sepse fiton, mbush stadiumet ose ka miliona mbështetës që e ndjekin atë në TV. Do të jetë rruga e kundërt: Ronaldo, me reputacionin e tij si yll i futbollit botëror do të tërheqë në mënyrë ekspozicionale shumëkombëshe e mëdha, të cilët do të mbërrin në Itali për të nënshkruar edhe kontrata më të pasura. Dhe, në një rreth të virtuoz, këtu rriten tifozët, shikuesit dhe, sigurisht, të ardhurat nga të drejtat televizive.


Disa shenja tashmë tregojnë se është një bast i mirë: pas nënshkrimit të kontratës me CR7, biletat për fillimin e bardhezinjve u rritën me 30% dhe u shitën, dyqanet u sulmuan me bluza Ronaldo që kushtojnë deri në 155 euro, ndër më të shtrenjtat në Europë, vëren gazeta angleze. Edhe financimi duket se pajtohet me Agnelli: veprimet e ekipit janë

kopje të vlerës, kapitalizimi i kompanisë ka arritur 1.5 miliardë euro që nga korriku. Sot, për qarkullimin, Juventusit është në vendin e dhjetë në mesin e ekipeve europiane, megjithatë ai është i vetmi italian. Mënyra për t’u bërë numri një në mesin e klubeve të futbollit, një synim që Agnelli nuk e bëri të ditur nëse donte ta arrinte, është ende e gjatë: Manchester apo Real fitojnë mes 150 dhe 250 milionë euro më shumë, PSG ose Chelsea bëjnë më shumë të ardhura. Por, çfarë rrezikojnë bardhezinjtë: CR7 është 33 vjeç, një lëndim mund të errësojë fundin e karrierës së tij dhe planet e Agnelli. Ajo që është e sigurt është se për të amortizuar marrëveshjen e madhe, vini re Ft, Juventusin do të shërbejë disa kohë. Nuk luan në favor të saj Serie A, e cila tërheq vetëm 1.4 miliardë sezon në të drejtat televizive, për shembull ndaj 3.3 të Premierit dhe që lufton

për të riafirmuar në një shkallë ndërkombëtare, larg nga periudha magjike e viteve tetëdhjetë e nëntëdhjetë.

Ndërkohë që të ardhurat e stadiumit të Juventusit fluturojnë (në 2017-18 deri në 56.4 milionë euro nga biletat, një shifër e pritshme e rritjes, thotë Ft), qëllimi i vërtetë, në Torino është se prania e Ronaldos e bën biznesin komercial më fitimprurës.

Marrëveshja me “Adidas”, tashmë në proces, do të ishte sipas gazetës në diskutim për të përmirësuar kushtet e saj. Klubi gjithashtu do të fliste me sponsorët e rinj në Kinë. Por, rruga për të kthyer “Lady” në një markë globale duket e gjatë. Dhe në qoftë se futbollit italian nuk hyn në një Rilindje totale, – komenton Ft, – do të jetë gjithashtu e vështirë. Në fund, vetëm një “Ronaldo” nuk mund të jetë i mjaftueshëm. Neymar a Mbappé, cili është i ardhshmi? (*gazeta-shqip.com*)





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës

Nr. 01-111-145518
Dt. 26.09.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Pozita – Pastrues në Shtëpinë e Kulturës-Gjonaj

Koeficienti – 5

Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj) Nr. i ekzekutuesve: 1 (një)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen dhe mirëmban higjienën në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës si dhe në hapësirat me gjelbërim, njëkohësisht pastron edhe jashtë ndërtesës.
- Rregullisht dhe me rregull pastron mjetet themelore, pajisjet si dhe inventarin.
- Kryen të gjitha punët rreth pastrimit dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Shtëpisë së Kulturës.
- Informon për defektet e ndryshme dhe kujdeset për eliminimin e tyre duke lajmëruar me kohë.
- Kryen edhe detyra tjera me kërkesën e eprorit.

Shkathësitë e kërkuara:

- Aftësi për përmbyshje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi etike dhe fizike.

Kushtet:

- Shkolla e mesme
- Trajnime të ndryshme

Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Ekstrakti i lindjes
- Dy - rekomandime (nëse këni)
- Diploma e Shkollës së mesme
- Certifikata të trajnimeve
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më 26.09.2018 deri më datën 10.10.2018 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. **Instruksione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/dhe-pas-plotësim-it-sipas-cdo-pike-të-aplikacionit,-i-bashkëngjitni-dokumentet-të-cilat-kërkojnë-sipas-konkursit-dhe-mund-të-aplikoni-tek-ne-drejt-përdrejtë> -Adresa jonë: në sportelin e pranimit nr. 2, në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" p.n. -Prizren. **VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në: tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 – 16:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit të dorëzimit të aplikacioneve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës.

Zyra e Personelit

Predsednik Opštine

Br. 01-111-145518
Dana 26.09.2018

Na osnovu člana 8 Zakona Br. 03/L-212 Rada, člana 4 Administrativnog Uputstva (MPMS) Br. 07/2017 za određivanje procedura konkursa u javnom sektoru, Opština Prizren, objavljuje:

KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA

Direktorijati za Kulturę, Omladinu i Sport

Pozicija – Čistač u Domu Kulture - Đonaj

Koeficijent – 5

Vrsta radnog mesta: na neodređeno vreme, puno radno vreme (probni rad 6 meseci)

Br. izvršilaca: 1 (jedan)

Zadaci i odgovornosti:

- Čisti i održava higijenu u prostorijama Doma Kulture kao i zelene površine, ujedno čisti i izvan zgrade.
- Redovno čisti osnovna sredstva, opremu i sitni inventar;
- Izvršava sve poslove oko čišćenja i održavanja nasleda Doma Kulture;
- Informiše o kvarovima i stara se o njihovom eliminisanju javljajući na vreme.
- Izvršava i druge poslove na zahtev nadležnog.

Tražene sposobnosti:

- Sposobnost za ispunjavanje zadataka i rada pod pritiskom;
- Fizičke i fizičke sposobnosti.

Uslovi:

- Srednja škola
- Razne obuke

Tražena dokumentacija:

- Fotokopija lične karte
- Ekstrakt rođenih
- Dve preporuke (ako imate)
- Diploma Srednje škole
- Certifikati obuka
- Potvrda da niste pod istragom.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja, počevši od dana objavljivanja 26.09.2018 do dana 10.10.2018 koji se smatra zadnjim danom zatvaranja konkursa. Dostavljene aplikacije nakon predviđenog roka neće se primati i manjkave aplikacije će biti odbijene. **Instrukcije za aplikaciju:** zahtev (Aplikacija) za zapošljavanje nalazi se na <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkursi-njoftimet/aplikacione/> i nakon popunjavanja prema svakoj tački aplikacije, priložite dokumenta koja se traže prema konkursu i možete aplicirati kod nas neposredno –Naša adresa: na šalteru prijema br.2, u objektu opštinske administracije u Opštini Prizren, ul. "Remzi Ademaj" b.b. -Prizren. **PAŽNJA:** Obaveštenja možete naći na Web stranici, a u slučaju potrebe možete kontaktirati tel: 038/200 44715 od 08:00 – 16:00 časova. Aplikacije primljene nakon određenog roka smatraće se primljenim, ako datum o dostavi zadnjeg dana roka ili bilo kakav drugi dokaz o slanju dokazuje da je ona poslata pre isteka roka za dostavu aplikacije. Konkurs je podjednak za sve cilijane kandidate, bez ikakve diskriminacije kao što je predviđeno Zakonom br. 03/L-212 Rada.

Kancelarija Personala

Belediye Başkanı

No. 01-111-145518

Tarih:26.09.2018

03/L-212 sayılı İş Yasasının 8. Maddesi, kamu sektöründe konkur süreçlerin düzenlenmesi ile ilgili 07/2017 sayılı İdari Yönergenin (ÇSRB) 4. Maddesi gereğince Prizren Belediyesi işbu ilanı ilan etmektedir:

İŞ YERİN DOLDURULMASI İÇİN KONKUR

Kültür, Gençlik ve Spor Müdürlüğü

Makam – Gjonaj – Kültür evi için temizlik görevlisi

Maaş seviyesi: 5

İşyeri türü : Süresiz, tam mesaili (deneme süresi 6 ay)

İcracı sayısı: 1 (bir)

Görev ve sorumluluklar:

- Kültür evi, yeşil alanların hijyeninden sorumludur aynı zamanda binanın dışını da temizler.
- Düzenli olarak ve uygun şekilde temel araçları, gereçleri ve küçük envanteri temizler.
- Kültür evin mal varlığının temizlik ve bakımı ile ilgili çalışmaların tamamını yerine getirir.
- Çeşitli bozukluklarla ilgili bilgilendirir ve sorunların ortadan kaldırılmasıyla ilgili zamanında bilgi sunar.
- Amirin talebi doğrultusunda başka görevleri de yerine getirir

Gerekli beceriler:

- Görevleri ve baskı altında çalışmalarını yerine getirebilme becerisi;
- Etik ve Fiziksel Beleri.

Koşullar:

- Orta okul
- Çeşitli eğitimler

Gerekli belgeler:

- Kimliğin kopyası
- Doğum ekstresi
- İki tavsiye (eğer varsa)
- Orta okul diploması
- Eğitim sertifikaları
- Sicil kayıt belgesi.

Konkur, 26.09.2018 yayımlanma tarihinden 10.10.2018 tarihine kadar yani konkurun kapanışına kadar 15 takvim günü için daha uzatılacaktır. Bu süre zarfında iletilmeyen ve tamamlanmamış belgeler kabul edilmeyecektir.

Başvuru talimatları: Mürakat talebi www.kk.rks-gov.net/prizren/kategori/konkurlar/bildiriler/uygulamalar adresinde bulunmaktadır ve belge başvurunun her bir noktasına göre tamamlandıktan sonra, konkur gereğince talep edilen evraklar da eklenerek doğrudan Prizren " Remzi Ademaj " caddesi, Prizren Belediyesi yönetim binasının 2 numaralı kabul girişine mürakat edebilir.

DİKKAT: Bildirileri Web'de bulabilirsiniz fakat ihtiyaç duymanız halinde 08:00-16:00 saatleri arasında 038/ 200 44715 telefon numarasından ulaşabilirsiniz. Belirlenen süre sonrasında kabul edilen başvurular kabul edilmemiş olarak nitelendirilir, eğer posta ileti tarihi ya da herhangi bir başka gönderi tarihi başvuru teslimat süresinden önce gönderildiği kanıtlanır ise. Konkur 03/L-212 sayılı İş Yasasında öngörüldüğü üzere ayırım yapılmaksızın hedeflenen adayların tamamı için eşit olacaktır.

Personel Dairesi

Njoftim

Të premtën më 5 tetor 2018, departamenti i Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë, do të organizohet mbrojtja e disertacionit të Doktoraturës të kandidatit Muhamet Jahiri. Ceremonia e mbrojtës fillon nga ora 10, në Amfiteatrin e Fakultetit të Filologjisë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuar i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration
Instituti i Kosovës për Administratë Publike
Institut Kosovo za Javnu Administraciju - Kosovo Institut for Public Administration

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L - 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Instituti i Kosovës për Administratë Publike shpall :

KONKURS

Drejtorati i Financave dhe Shërbimeve të Përbashkëta

Titulli i punës : Zyrtar/e për Hulumtim (1 vend pune)

Nr.ref. RP00072340

Kategoria funksionale : Niveli Profesional

Koeficienti : 7

Lloji i pozitës : JO karrierës

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës JO karrierës (me afat të caktuar) - periudha provuese 3 muaj

Vendi i punës : Prishtinë, Kompleksi i Rilindjes, Kontejneri Nr: 3

Qëllimi i vendit të punës : Hulumtimi dhe përpunimi i të dhënave

Nëpunësi raporton te : Drejtori i Drejtoratit

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Bën përpunimin e të dhënave statistikore të hulumtimit;
2. Bën dizajnimin (radhitjen) e raportit të hulumtimit;
3. Përgatit shpenzimet e nevojshme me arsyetim për punën që duhet të bërë;
4. Organizon punën për lektor, përkthim dhe botim të punimeve të ndryshme;
5. Bën raportin e punës sipas nevojës;
6. Kryen edhe punë tjera shtesë sipas kërkesës së Drejtorit;

Kualifikimi dhe përvoja ;

- Diplomë Universitare, Administratë Publike, Juridik, Shkenca Shoqërore;
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohja e gjuhës angleze në të folur, shkruar dhe lexuar;
- Njohuri nga lëmia e hulumtimeve;
- Aftësi të mira intervistuese;
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi;
- Aftësi për të punuar si pjesë e ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel,);
- Leje valide për vozitje, kategoria B;

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Instituti i Kosovës për Administratë Publike/ Zyra e Personelit, Kompleksi i Rilindjes, Kontejneri Nr: 3 kati II (dytë), zyra nr. 118, Prishtinë, Kosovë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në nr. e tel: 038 / 200-31-029, prej orës 08:00 - 16:00. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

"Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

"Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen".

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration
Instituti i Kosovës për Administratë Publike
Institut Kosovo za Javnu Administraciju - Kosovo Institut for Public Administration

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova Zakon. Br. 03/L - 149 i Uredbe Br. 02/2011 god., o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje:

KONKURS

Direkcija Finansija i Opštih Usluga

Naziv Rada : Zvaničnik/ca za istraživanja (1 radno mesto)

Br.ref.RN0000

Funkcionalna Kategorija: Profesionalni nivo

Koeficijent : 7

Vrsta pozicije : NE Karijere

Radno vreme : 40 časova nedeljno

Trajanje imenovanja: Zvaničnik NE karijere (sa određenim rokom) - probni period: 3 meseci

Radno mesto: Priština, Kompleks Rilindje, Kontejner Br: 3

Cilj radnog mesta : Istraživanje i obrada podataka

Zvaničnik izveštava kod: Direktora Direkcije

Glavni zadaci i odgovornosti:

1. Vršiti obradu statističkih podataka istraživanja;
2. Vršiti izradu (raspoređivanje) izvještaja o istraživanju;
3. Priprema neophodne troškove uz opravdanost potrebnog rada;
4. Organizuje rad za lektora, prevod i izdavanje različitih radova;
5. Pravi izveštaj o radu po potrebi;
6. Radi dodatne poslove po zahtevu Direktora;

Kvalifikacije i iskustvo;

- Univerzitetski stepen, Javna Uprava, Pravo, Društvene Nauke;
- Najmanje 2 godine profesionalnog iskustva;
- Poznavanje engleskog jezika u govoru, pisanju i čitanju;
- Znanje u oblasti istraživanja;
- Dobre veštine intervjuisanja;
- Odlične komunikacijske veštine;
- Sposobnost da radi kao deo tima;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel,);
- Važeću vozačku dozvolu za kategoriju B;

Podizanje i dostava aplikacija:

Kosovski Institut za Javnu Upravu/ Kancelarija Osoblja, Kompleks Rilindje, Kontejner Br: 3 sprat III (treći), kancelarija br. 118, Priština, Kosovo. Za detaljnije informacije možete da kontaktirate sa Kancelarijom Osoblja na tel. br.: 038 / 200-31-029, od 08:00 - 16:00. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.

Aplikacije poslate poštom, koje imaju pečat o dostavi u pošti do poslednjeg dana konkursa smatraće se važećim i biće uzeta na razmatranje, u koliko dođu u roku od 4 dana, aplikacije koje stignu nakon ovog roka i koje nisu kompletirane neće se razmatrati uopšte.

"Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i dočekuje aplikacije iz svih osoba muškog i ženskog pola od svih zajednica na Kosovu."

"Ne većinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave kako je navedeno u Članu 11. stav 3. Zakona br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republika Kosovo."

"Aplikacije dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene."

Uz aplikacije dostavljati kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvo i druga potrebna dokumentacija koja je potrebna za to radno mesto za koju konkurirate. Samo izabrani kandidati u užem spisku će biti kontaktirani.



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.



KOMUNA E PRIZRENIT
Drejtoria për Shëndetësi



Qendra Kryesore e
Mjekësisë Familjare

Rruga Joni pa nr.20000 Prizren-Kosovë tel. +38/200-35-344 qkmf.pz@gmail.com

Njësisë e Burimeve Njerëzore, lidhur me Konkursin publik të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren, të publikuar në tri gjuhët lokale: shqipe, boshnjake dhe turke, bie këtë:

NJOFTIM

Mbi anulimin e Konkursit Publik për plotësimin e vendit të punës për punë dhe detyra specifike (të përsëritur) Nr.12/4 të datës 05.09.2018

**për pozitën:
GINEKOLOG/E- 1 (një vendë pune)**

Anulimi i këtij Konkursi bëhet duke u bazuar në rekomandimin e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit, pasi që janë evidentuar disa lëshime në shpalljen dhe rishpalljen paraprake të këtij konkursi, përkatësisht të shkeljes së nenit 4 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

26.09.2018

Ju falënderojmë për mirëkuptim.

OPŠTINA PRIZREN
Direktorijati za Zdravstvo

Glavni Centar
Porodične Medicine

Jedinica Ljudskih Resursa u vezi javnog Konkursa Glavnog Centra Porodične Medicine, objavljen na tri lokalna jezika: albanskom, bošnjačkom i turskom jeziku, donosi sledeće:

O B A V E Š T E N J E

O poništenju Javnog Konkursa za popunjavanje radnog mesta za specifične zadatke (ponovljenog) Br.12/4 datum 05.09.2018.

za poziciju:

Ginekolog – 1 (jedno radna mesto)

Poništenje ovog Konkursa vrši se na osnovu preporuke Direkcije za Zdravstvo Opštine u Prizrenu, pošto su evidentirane neke propusti u obaveštenju konkursa, kao i u predhodnom obnavljanju ovog konkursa, odnosno prekršenjem člana 4 stav 3 Administrativne Instrukcije br.07/2017 o rregullisanju procedura konkursa na javnom sektoru,

26.09.2018

Zahvaljujemo na razumevanju

PRIZREN BELEDIYESI
Sağlık Müdürlüğü

Aile Hekimliği Ana Merkezi

Prizren Aile Hekimliği Ana Merkezi'nin 3 (üç) yerel dilde (Arnavutça, Boşnakça ve Türkçe) yayımlanan Kamu Konkuru ile ilgili, İnsan Kaynakları Birimi işbu

BİLDİRİ'yi

yayınlıyor.

Özel iş ve görevlerin tamamlanması için yayımlanan 12/4 sayılı ve 05.09.2018 tarihli (tekrarlanan) Kamu Konkuru'nun iptal edilmesine karar verildi.

Pozisyon:

JİNEKOLOG - 1 (bir iş yeri)

İşbu Konkuru'nun iptali Prizren Belediyesi Sağlık Müdürlüğü'nün tavsiyesine dayanılarak yapılır, çünkü konkuru'nun ilanı ve yeniden ilanı yapılırken, bazı hatalar tespit edilmiştir, yani Kamu Sektöründe Konkuru prosedürlerin düzenlenmesi ile ilgili 07/2017 sayılı İdari Talimatın 4. maddesinin 3. fıkrasının ihlali söz konusu'dur.

26.09.2018

Anlayışınız için teşekkür ediyoruz.

Anlayışınız için teşekkür ederiz.

AUTOSHKOLLA "RITMO – L"

Auto Shkolla "RITMO - L" Prishtinë

Eksperiencia jonë - përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas/Dragas
Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/660

Më: 27/09/2018

D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2018/2019.

SHFMU " 28 Nëntori"- Bresanë

1. Një mësimdhënësi për mësim klasor (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

SHFMU "Ulina" –Kosovë

2. Një mësimdhënësi për mësim klasor (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

SHFMU "Fetah Sylejmani" Dragash

1. Një mësimdhënësi për mësim klasor – Xërrxe

SHFMU "Shaban Shabani" Llopushnik

1. Një mësimdhënësi i lëndës së Kimi (18 orë) (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

SHML"Ruzhdi Berisha" Dragash

1. Një mësimdhënësi të lëndëve mjekësore me (10 orë)

2. Një mësimdhënësi për lëndët e mjekësisë për mësim praktik (10 orë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 27.09.2018
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zastite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës bazuar në nenin 11 të Ligjit për Shërbimin Civil dhe në Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 22 paragrafi 3 (pasi që nuk është arritur pranimi i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik), vazhdon afatin e konkursit të shpallur më datë 12.09.2018 edhe për shtatë (7) ditë tjera kalendarike nga data 27.09.2018 deri me datën 03.10.2018, për pozitat si në vijim:

1. Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
2. Zyrtar për Shpenzime

Kriteret e konkursit mbeten të njëjta si në konkursin e mëparshëm. Kandidatët që kanë aplikuar në afatin e rregullt të konkursit për pozitat e lartpërmendura nuk kanë nevojë për riaplikim.

BAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Agjencia za Zapošljavanje Republike Kosovo, na osnovu člana 11 Zakona o Državnoj Službi i Pravilnika br. 02/2010 o Procedurama Zapošljavanja u Državnoj Službi člana 22 stav 3(stoga da nije dostiglo prijem jednom balansiranom broju aplikacija iz etničkog aspekta), nastavlja sa produženjem roka konkursa objavljenom dana 12.09.2018 godine jos za sedam (7) ostalih kalendarskih dana počevši od 27.09.2018. do 03.10.2018, za sledeće pozicije:

1. Direktor Departmana za Finansije i Opšte Usluge
2. Službenik za troškove

Kriterijumi za konkurs ostaju isti kao i na prethodnom konkursu. Kandidati koji su konkurisali na redovnom konkursu za pomenuta radna mesta nemaju potrebe za ponovno konkurisanje.

**SHKOLLA E MESME E LARTË TEKNIKE „ARKITEKT SINANI” MITROVICË**

Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë me kërkesën e S.H.M.L.T. „Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, c në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për arsimin dhe aftësimin e të rriturve dhe Rregulloren Nr.07/2017 të KK dhe UA të MASHT-it për planifikimin e shpenzimeve dhe krijimin e të hyrave të shkollave profesionale për regjistrimin e kandidatëve në arsimin e të rriturve, publikon:

K O N K U R S**Për këto lëmi arsimore:****ELEKTROTEKNIKË**

Profillet arsimore: 1.Informatikë.....24 nx.
2.Telekomunikacion.....24 nx.
3.Energjetikë.....24 nx.
4.Instalues elektrik.....24 nx.

MAKINERI

Profillet arsimore:1.Operator i prodhimit..... 24 nx.
2.Automekanik.....24 nx.
3.Saldator.....24 nx.
4.Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit...24 nx.

NDËRTIMTARI

Profillet arsimore: 1.Ndërtimtar.....24 nx.
2.Arkitekturë.....24 nx.

TRANSPORT DHE TRAFIK RRUGOR

Profillet arsimore: 1.Trafik rrugor.....24 nx.

KIMI-TEKNOLOGJI

Profillet arsimore:1.Laborant i kimisë.....24 nx.
2.Gjeologji.....24 nx.
3.Metalurgji (Përfitues i metaleve).....24 nx.
4.Miniera.....24 nx.

TEKNOLOGJI USHQIMORE

Profillet arsimore: 1.Teknologji ushqimore.....24 nx.

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i vijnë 18 javë mësim.

Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur bëhet në bazë të nenit 17 të Rregullores Nr.07/2013 dhe administrativ të MASHT-it. Pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur është:

- Për regjistrimin e vitit (për një klasë)100 €
- Për praktikë profesionale50 €
- Provimi diferencial10 €
- Provimi përfundimtar (certifikatë)..... 50 €
- Riprovimi, për një lëndë 10 €
- Për diplomë20 €

Drejtoria komunale e Arsimit
D r e j t o r
Iset Beka

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompani " BLIC SOLUTION – MALISHEVË " SH.P.K me seli në malishevë ka marrë vendim të shuajë biznesin me numer të regjistrimit 71353885 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillim të procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë – Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo sve klijente da Tvrtka "BLIC SOLUTION - MALISHEVA" SH.P.K u Mališevu donijelo odluku da ugasi biznis po. Br.registra: 71353885 i ujedno imenovao likvidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Svi klijenti koji imaju izvještaje o kreditu - dužniku u ovoj kompaniji obaveštavaju se u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "BLIC SOLUTION – MALISHEV " SH.P.K in Malisheva has come to the decision to quit its business with registry: 71353885. The Company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgages- mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day newspaper announcement publication.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

